# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7889 E martë 21 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

PR PRESTIGE Resort



KORÇA BEER ... edhe sot më e mira

Opinioni i Ditës

Nga EDVAL ZOTO

## Ndërhyrje të jashtme në opinionin publik e mjedisin politik



Ndërhyrja e aktorëve të jashtëm me synime të fshehta do të jetë një çështje që do të karakterizojë e ndikojë gjithnjë e më gjerësisht zhvillimet kryesore ...

Vijon në faqet 20-21

Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI

## Rilindja e vrasësve politikë



Dy ditë më parë gazeta e së majtës, "Dita", botoi një dokument shumë domethënës që rrënonte propagandën e socialistëve për 21 janarin. Sipas saj, Agron Malaj ...

Vijon në faqen 21

KOMISIONI I PUNES MIRATON PROJEKTLIGJIN, SA DO MARRIN PUNONJESIT E NENTOKES

# RRITJE PENSIONESH PER 23 MIJE VETA, PERFITUESIT

Kreu i Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado shpjegon shtesat për vitet e vjetërsisë në punë. Tabelat me kategoritë përfituese, minatorët, naftëtarët e metalurgët



*(Në foto)* Pensioniste

Në faqen 11



"Kush prek votën, nuk shkel në SHBA-BE"

## PS hap fushatën më 31 maj, Edi Rama: Regjistroni incidentet në ditën e zgjedhjeve

Kryemadhi me shqiptarët në Itali: Shqipëria nuk ka nevojë për lider të fortë, por për sistem

Vetëm 4 ditë nga mbajtja e protestës së radhës kombëtare të opozitës, socialistët janë të bindur që të shkojnë në zgjedhjet e 30 qershorit pa patur një garë reale ku qytetarët mund të zgjedhin mes alternativave. Jo vetëm kaq, por socialistët në përmbushje edhe të detyrimit ligjor, do ta çelin fushatën elektorale fiks 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Kryetari ...

Në faqet 2-3

OPOZITA

## Basha: Viktimat e komunizmit, jo më harresë, do të ndëshkojmë krimin

Në faqen 2

DREJTOJNE ZEVENDESIT

## "Skandal kombëtar", në mbledhjen e dy qeverive mungojnë Rama dhe Haradinaj

Në faqen 5

EMRAT

## Lista e plotë, 1600 infermierët që do të kryejnë provimin e shtetit

Në faqen 12

OPERACIONI

## Vidhnin valixhet e udhëtarëve, kapen dy punonjësit e bagazheve në Rinas

Në faqen 6

LISTA EMERORE



## Legalizimet, 2 mijë pronarët që marrin tapitë e truallit të ndërtimit

Në faqet 9-10

INTERVISTA/ Ish-aktorja rrëfen për "GSH" si e shkroi romanin "15 ditë prilli"

## Anisa Markarian: Diktatura dhe roli i ëndrrave

*"Despotët lindin në çdo kohë, kur i brohorasim e votojmë symbyllur"*

NGA FATMIRA NIKOLLI



Përshkruhet mjeshtërisht nga Anisa Markarian, si shumë tablo të romanit të saj, pasi ky roman është si një vijimësi tablosh të jetës shqiptare, si një lloj libri i madh me kapakë të rëndë, ku ne gjejmë jetën tonë. Është një dëshmi, ku ndryshe nga dëshmia dokumentare, ajo është letrare, një letërsi tashmë e lëvruar gjerësisht që nga Pasternaku, Solzhenicini etj., si dhe autorët e gjithë Lindjes europiane pas rënies së Murit të Berlinit, vazhduar me "Shakanë" ...

Në faqen 18

# KRIZA POLITIKE

## ZGJIDHJA




Kreu i PD-së Lulzim Basha, dje në Shkodër

Kreu i PD-së publikon "Magna Carta": Dhunimi i lirisë, shkak për përmbysjen e pushtetit

# Viktimat e komunizmit, Basha: Jo më harresë, do të ndëshkojmë krimin

## "Pengesa më e madhe për bashkëpunimin me PS-në"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, mori pjesë dje në inaugurimin e memorialit të viktimave të regjimit komunist në Shkodër. Memoriali është ndërtuar nga Bashkia e Shkodrës, në bashkëpunim të ngushtë me të persekutuar-it politikë, organizatën "Drejtësi dhe Paqe" dhe me bashkëfinancimin "Renovabis" e donatorë vendës e të huaj. Një memorial që lartëson realitetin e vuajtjes së intelektualeve, hoxhallarëve e priftërinjve, burrave e grave; të rinjve që vuajtën tmerrin, u masakruan, u internuan e u vranë. Teksa kujtoi heronjtë që dhanë jetën për të rrëzuar diktaturën hoxhiste, Basha përmendi se në Shqipëri për 50 vjet nuk janë dënuar krimet e komunizmit dhe që rrjedhin nga ideologjia staliniste. Basha shtoi se dje ishte ideologjia staliniste ajo që "vriste" shqiptarët, kurse sot krimi e vesi janë në pushtet. "Vij këtu me vetëdijen e plotë të peshës që kam unë dhe PD-ja, të vetëdijshëm se gjithçka është arritje në raport me borxhin e pashlyeshëm ndaj të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, që është meritë e Partisë Demokratike dhe gjithçka që nuk është arritur është e jona, edhe zotimi është i yni për ta çuar deri në fund. Sot ajo që na pengon është lartësimi i vesit, i krimit, po kështu me sulmet denigruese ndaj atyre që kërkojnë të zbardhin të vërtetën, duke sulmuar Agron Tufën, Çelo Hoxhën dhe të gjithë të tjerët. Një nga arsyet kryesore është se e lamë harresën të ngrinte krye mbi kujtesën dhe nuk i dhamë ndëshkimin final. Përtej çdo dëmshpërblimi financiar, bëhet fjalë për diçka më të madhe që është dënimi i krimit në nivel kombëtar dhe koha ka ardhur", - deklaroi z.Basha.

**PARALAJMËRIMI**

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, paralajmëroi një tjetër shtyrje të hapjes së negociatave për Shqipërinë në 30 qershor. "Për fat të keq, shtyrja pak a shumë është vendosur. Vende anëtare kanë dalë në përfundimin se progresi i Shqipërisë drejt përmbushjes së kushteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit është i pamjaftueshëm. Pyetja shtrohet: çfarë vjen pas kësaj? Problemi më i madh është sesi të kapërcehet kjo krizë e thellë, e cila tani po shpërthen me zemërim nëpër rrugë dhe sheshe", theksoi kreu i PD-së. Basha shigjeton Brukselin për raporte që sipas tij janë larg realitetit të Shqipërisë dhe shprehet se dera e Unionit mund të hapet vetëm pasi vendi të ketë zgjidhur problemin e zgjedhjeve të vjedhura dhe të jenë shkëputur lidhjet e qeverisë me krimin. Në intervistën radifonike për "BBC World", Lulzim Basha bëri të qartë se forca politike që drejton distancohet nga dhuna në protestat e saj kombëtare, por e kupton zemërimin në rritje të qytetarëve. "Absolutisht. PD ka bërë gjithmonë thirrje për protesta jo të dhunshme. Ështё të distancuar dhe do të distancohet gjithmonë nga dhuna. Megjithatë, duhet kuptuar se dhuna e izoluar falë Zotit nuk shkaktoi viktima. Asnjë person i vetëm nuk u plagos, asnjë polic nuk u lëndua, por është shprehje e zemërimit në rritje. Këto protesta janë pasojë e një krize që ka shpërthyer me të gjithë fuqinë gjatë 4 muajve të fundit: krizë kushtetuese, krizë politike dhe pasojat e saj ekonomike e sociale", tha z.Basha. Kreu i PD-së shprehu domosdoshmërinë për hapjen e negociatave të Shqipërisë në Bashkimin Europian, pavarësisht situatës së krimit të organizuar dhe korrupsionit.

**DOKUMENTI**

Kreu i demokratëve, Lulzim Bashan tregoi dje se gjatë vizitës së tij në Parlamentin britanik ka vizituar edhe dhomën ku ndodhet "Magna Carta", dokumenti 800-vjeçar, që flet për të drejtat dhe liritë themelore të njerëzimit. Sipas Bashës, ky dokument manifeston parimin bazë të demokracisë perëndimore, që nënkupton se liria dhe të drejtat e njeriut mbrohen me ligj dhe se dhunimi i tyre është shkak për përmbysjen e çdo pushteti. "Të dashur miq, këtë foto e mora nga panelet e Westminster, ndërtesës historike të Parlamentit britanik, nënës së gjithë parlamenteve. Është 'Magna Carta', dokumenti 800-vjeçar që ka frymëzuar betejat më madhështore për liri në botë këto 8 shekuj, nga Reforma e Monarkisë Britanike te Revolucioni Amerikan dhe ai Francez. Madhështia e saj qëndron tek ideali i shenjtë dhe parimi bazë i demokracisë perëndimore se liria dhe të drejtat e njeriut mbrohen me ligj dhe se dhunimi i tyre është shkak për përmbysjen e çdo pushteti. 'Magna Carta' është mantra e kufizimit të pushtetit me ligj dhe ndërtimit të shoqërisë mbi barazinë para ligjit dhe respektin për të drejtat dhe liritë e çdo njeriu. 'Magna Carta' është Karta e Madhe që e bëri Britaninë të madhe, sepse vendosi precedentin se mbi të drejtat dhe dinjitetin e njerëzve nuk ka pushtet mbi tokë përveç pushtetit të njerëzve nga njerëzit dhe për njerëzit!", - shprehet z.Basha.



Kreu i PD-së Lulzim Basha

**PENDESA**

"Një nga arsyet kryesore është se e lamë harresën të ngrinte krye mbi kujtesën dhe nuk i dhamë ndëshkimin final. Përtej çdo dëmshpërblimi financiar, bëhet fjalë për diçka më të madhe, që është dënimi i krimit në nivel kombëtar. Dhe koha ka ardhur", - deklaroi z.Basha.

**AKUZA**

Z.Basha premtoi rikthimin e ligjit për ish-të përndjekurit politikë kur të vijë PD në pushtet. "Pengesa më e madhe për bashkëpunimin me PS është lartësimi prej vesit dhe kriminelëve, njësoj si diktatura komuniste", u shpreh kreu i PD-së.

## Kryemadhi në Itali: Shqipëria s'ka nevojë për lider të fortë, por për sistem

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, me ftesë të komunitetit shqiptar që jeton e punon në rajonin e Alto Adige të Italisë ku jetojnë rreth 4000 shqiptarë, gjendet prej dy ditësh në komunën e Bolzanos. E shoqëruar nga ish-deputetët e LSI-së, Përparim Spahiu e Viktor Tusha, Kryemadhi zhvilloi një takim bashkëbisedues me rreth 400 shqiptarë, me të cilët ndau shqetësimet lidhur me situatën në Shqipëri dhe këndvështrimin e LSI-së për daljen nga kriza. "Unë mendoj që Shqipëria nuk ka më nevojë për lider të fortë. Ne kemi nevojë për një sistem, i cili u del garant qytetarëve të tij. Përderisa ne të gjithë paguajmë taksa nga i pari deri tek i fundit, nuk ka



përse sistemi të mos u përgjigjet qytetarëve të tij", theksoi zj.Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së theksoi se ajo ka nisur një tur takimesh për të dëgjuar qytetarët, sepse për LSI-në ka një rëndësi shumë të madhe dëgjimi i zërit të tyre. "Prandaj ne kemi nisur një tur, jo për të dhënë mendimet tona, por më shumë për të dëgjuar. Sepse mendojmë se është shumë e rëndësishme për t'i dëgjuar njerëzit". Gjithashtu, në ditën e dytë të vizitës, Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, zhvilloi një takim kortezie me kryetarin e Bashkisë së Bolzanos, dr. Renzo Caramaschi. Z.Caramachi shprehu vlerësimet më të larta për komunitetin shqiptar në Bolzano dhe kontributin e tyre në jetën e qytetit. Kryetarja e LSI-së, Kryemadhi shprehu mirënjohjen për mbështetjen ndaj shqiptarëve, për të përballuar vështirësitë e jetës në emigracion si dhe e ftoi kryetarin Caramachi për të vizituar Shqipërinë, për të synuar edhe mundësinë e binjakëzimeve e bashkëpunimit të bashkive shqiptare me Bashkinë e Bolzanos.

## Gjyq me deputeten e PS, Salianji: Firma e burrit arriti në 3 mld lekë

Ish-deputeti i PD, Ervin Salianji, u përball dje në gjykatën penale me padinë e deputetes socialiste Klotilda Bushka Ferhati. Salianji e akuzoi atë pas ardhjes në pushtet të PS-së, deputete e së cilës ajo është pasuria e burrit të saj u disafishua. Në një deklaratë për mediat, pas seancës Salianji theksoi se për këtë ka prova të qarta, dale direkt nga tabelat financiare të të ardhurave të kompanisë së familjes apo bashkëshortit të deputetes socialiste. "Këta duan edhe të zhvatin, edhe vjedhin, edhe t'u thuash bravo u qoftë. Këtu kam pasqyrat financiare të kompanisë 'Selcom', që është kompania e bashkëshortit të vet, e cila në 2012-ën kur nuk ka qenë në pushtet Rama ka pasur një bilanc negativ. Me ardhjen në pushtet të Rilindjes ka rilindur edhe kompania e burrit të deputetes. Vetëm te kjo kompani xhiroja e tij ka arritur në 3 mld dhe disa milionë lekë. Kjo është akuza që kam bërë më parë, kjo është akuza që do ta përballim edhe në gjykatë", - tha Salianji.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**,** ***Marketingu*:** Cel:**0688087823-*email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Pëllumbi u ka përcaktuar 4 detyra strukturave

## Zbulohet udhëzimi i PS: Të rritet pjesëmarrja e votuesve në zgjedhje

Socialistët e konsiderojnë tashmë si një vendim pa kthim, shkuarjen në zgjedhjet e 30 qershorit edhe nëse opozita reale nuk do të bëhet pjesë e tyre. Jo vetëm kaq, por Partia Socialiste ka nisur të marrë masat edhe për të parandaluar çdo tentativë të opozitës për të prishur zgjedhjet, si dhe për t'u dhënë zgjedhjeve edhe legjitimitet moral nëpërmjet një pjesëmarrjeje sa më të madhe të zgjedhësve në votime. Për këtë qëllim, sekretari organizativ i PS-së, Arben Pëllumbi ka nisur një udhëzim të gjitha strukturave partiake në bazë dhe kandidatëve për kryetar bashkie, ku u përcakton 4 detyra kryesore. Në krye të tyre listohet porosia për të nxjerrë sa më shumë zgjedhës në votime. "Në kushtet specifike të fushatës për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor të 30 qershorit, kur opozita jashtëparlamentare PD-LSI nuk merr pjesë në zgjedhje, për strukturat e Partisë Socialiste dalin disa detyra për t'iu përgjigjur këtyre kushteve të zgjedhjeve. Së pari, të synohet dhe realizohet pjesëmarrje sa më e lartë në votime. Pjesëmarrja në votime jo vetëm të ruajë shifrat e rezultateve për PS dhe të partive të koalicionit 'Aleanca për Shqipërinë Europiane' në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, por të përcaktohen detyra për rritjen e pjesëmarrjes (jo më pak se 2.5 për qind që është rritja e numrit të zgjedhësve krahasuar me dy vjet më parë)", - thuhet në këtë udhëzim. Në kuadër të kësaj detyre të parë është edhe porosia që të evidentohen rastet e veprimtarisë së opozitës joparlamentare për pengimin e zgjedhësve për të marrë pjesë në votime, për presione e kërcënime. Së dyti, udhëzimi kërkon të përcaktohen dy-tri prioritete kryesore për çdo bashki nga ato që kanë dalë gjatë llogaridhënies së tyre në publik, sidomos atje ku drejtojnë përfaqësues të PS, dhe të merren masat për plotësimin e tyre. Prioritetet që do të përcaktohen në çdo bashki duhet të dërgohen në zyrën e Organizimit të Partisë brenda datës 25 maj 2019. Detyra e tretë ka të bëjë me marrjen e masave për caktimin e anëtarëve të komisioneve të Qendrave të Votimit, ndërsa detyra e katërt kërkon zbatimin e të gjitha kërkesave të Kodit të Zgjedhjeve për shpenzimet e fushatës, duke theksuar detyrimin që çdo veprim financiar të bëhet nëpërmjet bankës.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të **I-rë**, për shitjen e pasurisë **ARE**, me sip. **1045 m²**, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 319/24, Vol. 1, Faqe 220, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **836,000(tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) LEKË**.
Ankandi do të zhvillohet më datë **22.05.2019**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

Kryeministri kërkoi nga deputetët të mos provokohen dhe të regjistrojnë incidentet

# PS hap fushatën elektorale në 31 maj, Rama: Zgjedhjet nuk shtyhen

## "Kush prek zgjedhjet, nuk shkel në SHBA dhe BE"

Vetëm 4 ditë nga mbajtja e protestës së radhës kombëtare të opozitës, socialistët janë të bindur që të shkojnë në zgjedhjet e 30 qershorit pa patur një garë reale ku qytetarët mund të zgjedhin mes alternativave. Jo vetëm kaq, por socialistët në përmbushje edhe të detyrimit ligjor, do ta çelin fushatën elektorale fiks 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama mori pjesë dje në mbledhjen e Grupit Parlamentar Socialist, ku mësohet se ka bërë të qartë për të gjithë deputetët e tij që të mos kenë asnjë iluzion që zgjedhjet do të shtyhen, ndërsa i bëri të ditur po ashtu të bëhen gati për çeljen e fushatës elektorale në datën 31 maj në një takim në Pallatin e Kongreseve. Në hapjen e fushatës elektorale në datën 31 maj mësohet se të pranishëm do të jenë të gjithë kandidatët për kryetar bashkie, si dhe përfaqësuesit më të lartë të PS-së, përfshi gjithë deputetët dhe anëtarët e Asamblesë Kombëtare. Në fakt, mësohet se për shkak të situatës së ngarkuar politike dhe sjelljes së opozitës, mazhoranca do të preferojë që shumicat e takimeve elektorale, gjithmonë nëse nuk do ketë një marrëveshje që të fusë edhe të djathtët në zgjedhje, do të mbahen në ambiente të mbyllura, duke u kujdesur kështu që të shmanget çdo incident i mundshëm. Po ashtu gjatë kësaj mbledhjeje kreu i socialistëve u ka kërkuar deputetëve të vet që të angazhohen plotësisht në regjistrimin dhe dokumentimin e çdo incidenti apo tentative të përfaqësuesve opozitarë për të prishur zgjedhjet. Burime nga kjo mbledhje bënë të ditur se Rama është shprehur se pavarësisht faktit se PS ka ngritur një task-forcë për të menanxhuar dhe denoncuar çdo tentativë për të prishur zgjedhjet që drejtohet nga zëvendëskryeministri Erion Braçe, ajo e ka të pamundur që të kontrollojë gjithë situatën në të gjitha zonat. Ndaj ai i ka kërkuar deputetëve që të marrin përsipër menaxhimin e situatës zgjedhore në zonat e tyre elektorale dhe të bashkëpunojnë me taskforcën e ngritur për këtë qëllim. Nga ana tjetër ai i ka porositur deputetët e vet që të jenë kujdesshëm dhe të mos provokohen nga kundërshtari që sipas tij do ketë si qëllim të krijojë situata që do të prishin imazhin e zgjedhjeve. Gjithashtu, një tjetër porosi e dhënë nga kryeministri në këtë mbledhje ishte edhe ajo për të komunikuar me zgjedhësit mesazhin e dhënë edhe gjatë takimit të së shtunës me kandidatët për deputetë, se kushdo që prek zgjedhjet vendore do t'i ndalohet hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e Bashkimit Europian. "Mos u provokoni. Regjistroni ata që mund të shkaktojnë incidente. Të provojmë që nuk jemi ne shkaktarë. Të denoncojmë këdo që cenon zgjedhjet. Çdo njeriu i duhet thënë që kush cenon apo dëmton procesin, nuk shkel më në Amerikë apo vende të Bashkimit Europian" - mësohet të jetë shprehur kryeministri Rama, njëherësh kryetar i PS-së. Pavarësisht vendosmërisë së treguar nga shumica qeverisëse për të mos toleruar sa i përket datës së mbajtjes së zgjedhjeve, opozita në anën tjetër është po ashtu e vendosur që të mos hyjë në zgjedhje, ndërsa ka deklaruar prerë se nuk do të lejojë që ato të mbahen në 30 qershor. Javën e shkuar palët dhanë shenja të një afrimi drejt një dialogu të ndërmjetësuar edhe nga disa përfaqësues të partive të djathta gjermane, aleate të PD-së, por që nuk u finalizuan dot për shkak se ato nuk kanë hequr dorë nga qëndrimet e mëparshme. Kështu opozita thekson se nuk ulet në tryezë me Ramën si kryeministër, duke kërkuar dorëheqjen e tij dhe shtyrjen e zgjedhjeve në vjeshtë dhe nga ana tjetër qeveria ka bërë të qartë se nuk mund të dialogojë asgjë që prek Kushtetutën, përfshi këtu mandatin qeverisës dhe datën e zgjedhjeve.



Mbledhje e grupit parlamentar socialist

**POROSITË**

"Mos u provokoni. Regjistroni ata që mund të shkaktojnë incidente. Të provojmë që nuk jemi ne shkaktarë. Të denoncojmë këdo që cenon zgjedhjet. Çdo njeriu i duhet thënë që kush cenon apo dëmton procesin, nuk shkel më në Amerikë apo vende të Bashkimit Europian" - mësohet të jetë shprehur kryeministri Rama.

## Platforma, pas 30 qershorit qytetarët komunikim direkt me kryebashkiakët

Platforma e bashkëqeverisjes pas 30 qershorit do të shërbejë edhe për të gjitha problemet që shqetësojnë qytetarët dhe që i takojnë për t'i zgjidhur bashkive. Kryeministri Edi Rama në takimin radhës të bashkëqeverisjes me qytetarët nëpërmjet platformës "Shqipëria-qëduam.al", ka bërë të ditur se pas zgjedhjeve vendore qytetarët shqiptar do të kenë mundësi të komunikojnë direkt me kryetarin e bashkisë për të zgjidhur problemet e tyre, duke paralajmëruar kështu se platforma e bashkëqeverisjes do t'i shtrijë efektet e saj në të gjitha bashkitë e vendit, duke i dhënë mundësi çdo qytetari që t'i shkruajë direkt kryetarit të bashkisë për



problemin që ka. "Kam besim se në 30 qershor ne ndër të tjera do të krijojmë mundësinë edhe për të hyrë në një fazë të re të trajtimit të ankesave për bashkitë, qoftë edhe në aspektin sasior dhe cilësor. Nuk ka nevojë as për miq as për shokë as për kushërinj as për filtra të tjerë, por çdo qytetarë, njësoj si çdo deputet ka akses të drejtpërdrejtë tek çdo minister për problemin e vet. Çka do realizojmë është akses drejtpërdrejtë tek çdo kryetar bashkie të jetë i të njëjtës cilësi. Zgjedhjet nuk bëhen për ata që zgjidhen por ata që zgjedhin, dhe ata që zgjedhin më 30 qershor do të zgjedhin për të pasur akses të drejtpërdrejtë tek çdo kryetar bashkie që kanë dhënë ose nuk kanë dhënë votën e tyre", - bëri të ditur Rama. Duke prezantuar rastet që kanë gjetur zgjidhje Rama tha se platforma ka zgjidhur probleme të 35 mijë qytetarëve.

ZGJEDHJET
DEBATI

PD deklaroi se kërkohet zotërimi i mandatit të deputetit të paktën 6 muajt e fundit

# KQZ miraton kandidatët e Bindjes Demokratike për kryetarë bashkie

## Listat e BD mbështeten nga Lefter Koka dhe Andi Përmeti


Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës gjatë mbledhjes së djeshme

Bindja Demokratike e Astrit Patozit ka mundur të regjistrojë edhe zyrtarisht kandidatët e saj për kryetarë bashkie, që do të konkurrojnë për zgjedhjet e 30 qershorit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo pa debate miratoi dje disa nga kandidatët e parë që ka paraqitur Bindja Demokratike për kryetarë bashkie. Por, para se të kalojë në proces votimi, KQZ ka debatuar gjatë, pasi përfaqësuesit e partive opozitare kanë kundërshtuar fort regjistrimin e kandidatëve të kësaj force. Ata kanë pretenduar se vërtetimet e dorëzuara nga BD të dy deputetëve Andi Përmeti dhe Lefter Koka se janë përfaqësues të kësaj force nuk ishin të rregullta ligjërisht, ndaj edhe nuk mund të shërbenin për regjistrimin e listave të kandidatëve. Përfaqësuesi ligjor i Partisë Demokratike, Ivi Kaso, tha se regjistrimi i kandidatëve të Bindjes Demokratike ishte në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, i cili detyron një subjekt zgjedhor që për të regjistruar një kandidat ose të mbledhë firmat në popull, ose të ketë të paktën mbështetjen e një deputeti të vet në Kuvend të paktën 6 muajt e fundit para zgjedhjeve. Sipas tij, pavarësisht se Bindja Demokratike ka dorëzuar firmat e dy deputetëve (PD ka pretendime edhe për vërtetimin e lëshuar nga Kuvendi për këto raste) si mbështetës, ajo nuk plotëson kushtin që t'i ketë pasur deputetët e vet 6 muajt e fundit. Kjo për faktin se vetë Bindja Demokratike është krijuar pak javë më parë. "Kërkohet zotërimi mandatit të paktën 6 muajt e fundit. U vu dispozita për një arsye pikërisht për të shmangur mundësinë që subjektet që krijohen rishtazi, siç është ky rast, të shmangin detyrimin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 68 nëpërmjet marrjes në momentin e fundit të një deputeti, ose të një këshilltari bashkiak", - tha Kaso. Por, nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba, i kujtoi përfaqësuesit të PD-së që megjithëse qëndronte në tryezën e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, nuk ishte i legjitimuar që të shprehte mendimin e tij për këtë çështje, për sa kohë PD-ja nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 30 qershorit. "Një parti që nuk është regjistruar në zgjedhje nuk ka asnjë lloj legjitimiteti për t'u interesuar për subjektet që janë regjistruar në këto zgjedhje dhe që nuk janë konkurrentet tuaja në këto zgjedhje. Gjithsesi, ju kujtoj që fare mirë që vendimet e KQZ-së mund t'i ankimoni nëse mundeni në Kolegjin Zgjedhor", - tha Biba. Pjesë e debatit u bë edhe kryetari i KQZ-së, Klement Zguri, i cili propozoi që lista e kandidatëve të Bindjes Demokratike të mos miratohej dhe t'i kërkohej ndërkohë Kuvendit një shpjegim se kë subjekt politik përfaqësojnë dy deputetët Andi Përmeti dhe Lefter Koka në parlament. "Lefter Koka është deputet i Kuvendit dhe këtë nuk e kundërshton askush. Por, qëllimi për të cilin është lëshuar vërtetimi nuk më çon kurrkund, të paktën personalisht nuk më orienton të votojë një vendimmarrje që administrata ma ka sjellë. Ndaj, vërtetimet t'i kthehen Kuvendit dhe të sqarojë nëse subjekti në fjalë, Bindja Demokratike, zotëron mandat në Kuvend", - u shpreh Zguri. Por, ky propozim i Zgurit është hedhur poshtë dhe KQZ-ja me 4 vota pro dhe 1 kundër miratoi Arben Skënderin si kandidat për Bashkinë Tiranë, Valbona Mezinin si kandidate në Bashkinë e Vlorës, Valdona Sakollarin si kandidate për Bashkinë e Durrësit, Ylber Gjetën në Bashkinë Kamzës, Salvador Kaçajt në Bashkinë e Lezhës dhe Leonard Ollin si kandidat për Bashkinë e Korçës. Por vetëm pak çaste pas këtij vendimi, Salvador Kaçaj deklaroi dorëheqjen nga ky kandidim.


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DEMOKRATËT
"Kërkohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit. U vu dispozita për një arsye pikërisht për të shmangur mundësinë që subjektet që krijohen rishtazi, siç është ky rast, të shmangin detyrimin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 68 nëpërmjet marrjes në momentin e fundit të një deputeti ose të një këshilltari bashkiak", - tha Kaso.

## Lefter Koka: Mbështeta Patozin për t'u regjistruar, por mbetem i majtë



Pas debatit që shoqëroi sot mbledhjen e KQZ-së, ku u regjistruan disa nga kandidatët për kryetarë bashkie të Bindjes Demokratike, ka reaguar edhe deputeti Lefter Koka, i cili është një nga deputetët që janë deklaruar si përfaqësues të kësaj force në Kuvend. Falë mbështetjes së Lefter Kokës, KQZ-ja i konsideroi me shumicë votash si të rregullta listat e Bindjes Demokratike, ndërsa vetë Lefter Koka ka shpjeguar se vendosi të mbështesë këtë forcë politike për t'i dhënë mundësi krijimit të një klase të re politike opozitare, e cila sipas tij është domosdoshmëri. "Kuadri ligjor dhe vullneti i popullit për një rrugë të shpejtë të vendit drejt integrimit evropian ia jep Bindjes Demokratike këtë legjitimitet, ndaj me vullnet e bindje të plotë unë mora vendimin të mbështes me firmën time z. Patozi në rrugën e tij dhe mbështetësve të tij, duke vazhduar të besoj dhe aderoj në bindjet e mia të majta. Unë besoj se një klasë e re politike opozitare është domosdoshmëri për Shqipërinë demokratike e pluraliste. Si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe si i majtë, nuk do i toleroja asnjëherë vetes të mos angazhohesha në një situatë të turbullt politike si kjo që vendi po kalon sot. Pa retorikë, pa mashtrime politike, por me kontribut real. Fatmirësisht sot jam i lirë të mbështes çdo parti, kryetar partie apo individ që unë gjykoj se japin një garanci më shumë për të ardhmen e sigurt të vendit. Më duhet të ndaj mbështetjen për individin, pasi sot fatkeqësisht shohim se individët shpesh kanë rol më të rëndësishëm se zëri i partisë", - shkroi Koka.

TAKIMI
Regjistrimi i kandidatëve të Bindjes Demokratike ishte në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, i cili detyron një subjekt zgjedhor që për të regjistruar një kandidat ose të mbledhë firmat në popull, ose të ketë mbështetjen e një deputeti të vet në Kuvend të paktën 6 muajt e fundit para zgjedhjeve.



## Tërhiqet kandidati i BD për Lezhën, Kaçaj: Nuk i shërbej fasadës

Kandidati i Bindjes Demokratike për kryetar të Bashkisë së Lezhës është tërhequr nga kandidimi. Vendimi i tij erdhi vetëm pak momente pasi KQZ-ja kishte miratuar kandidaturën e tij dhe në deklaratën e dorëheqjes Kaçaj bën të ditur se nuk mund të bëhet pjesë e një procesi fasadë. Përmes një njoftimi drejtuar KQZ-së shprehet se dorëheqja e tij vjen sepse nuk i shërben dot fasadës dhe përpjekjes për të rikthyer në Shqipëri një regjim njëpartiak, të përzier me krimin. "Gjatë gjithë jetës sime profesionale dhe politike kam qenë pjesë e shumë garave, shumicën e tij të cilave i kam fituar. Edhe propozimin për të përfaqësuar Bindjen Demokratike në 30 qershor e vlerësova si një mundësi për të marrë pjesë në një garë për të mirën e Lezhës. Disa rrethana dhe informacione gjatë këtyre ditëve më kanë nxitur të rishikoj vendimin për të qenë kandidat në zgjedhjet e 30 qershorit nën siglën e Bindjes Demokratike. U jam mirënjohës qytetarëve dhe miqve të vërtetë që më bënë të kuptoj se ajo ku kisha pranuar të hyja nuk ishte një garë e vërtetë, por farsë në shërbim të pushtetit të Edi Ramës. Unë nuk mund të shërbej si fasadë e përpjekjes për të rikthyer në Shqipëri një regjim njëpartiak, të përzier me krimin", - shkruan Kaçaj në deklaratën e vet.



### MARRËVESHJET

**1.** Nënshkrimi i marrëveshjeve për heqjen e çmimeve për shërbimin 'roaming'.
**2.** Nënshkrimi i protokollit për kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën kufitare Morinë-Vernicë.
**3.** Nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhënieve me institucionet financiare ndërkombëtare.

Sfida e menaxhimit të kufijve, angazhimi i Kosovës dhe Shqipërisë në katër fusha

# Mbledhja e përbashkët e dy qeverive, mungojnë Rama dhe Haradinaj

## *Replikat në distancë, mbledhjen e drejtojnë Braçe dhe Limaj*

Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës zhvilluan dje takimin e dytë koordinues lidhur me marrëveshjet e nënshkruara në 26 nëntor 2018. Takimi filloi në orën 12:00, në Pallatin e Kongreseve, ndërkohë nuk ishin të pranishëm kryeministrat Rama e Haradinaj. Në mungesë të tyre, mbledhja u zhvillua nën drejtimin e zv.kryeministrave, Erion Braçe dhe Fatmir Limaj. Pas takimit në Pejë, në nëntor të vitit të shkuar, mbledhja e dy qeverive Shqipëri-Kosovë ishte parashikuar të mbahej gjatë muajit maj në Shkodër. Por ndryshe nga parashikimi, takimi koordinues mes dy qeverive u mbajt në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, ndërsa u vu re mungesa e dy kryeministrave Edi Rama dhe Ramush Haradinaj. Zëvendëskryeministrat Fatmir Limaj dhe Erjon Braçe drejtuan mbledhjen koordinuese për të bërë bilancin e realizimit të marrëveshjeve të kaluara. Gjatë këtij takimi Braçe theksoi se dy shtetet po punojnë për një treg të përbashkët, ndërsa e quajti sfidë të madhe menaxhimin e kufijve. "Ne po punojmë fort drejt krijimit të zone të përbashkët ekonomike në rajon. Pika doganore e Republikës së Kosovës në portin e Durrësit ka qenë një ambicie e hershme e dy qeverive tona. Menaxhimi i kufijve është një çështje komplekse, gati-gati një sfidë më vete, por nëse bashkëpunojmë dhe bashkërendojmë punën nëpërmjet strukturave tona, sfida bëhet shumë herë më e menaxhueshme", deklaroi z.Braçe. Zv.kryeministri Braçe kujtoi se kanë kaluar 5 vite nga mbledhja e parë e përbashkët e dy qeverive në Prizren, ku u nënshkrua dokumenti bazë i partneritetit strategjik. Ai përmendi se puna mes Shqipërisë dhe Kosovës duhet të fokusohet në katër fusha të mëdha. "Ne kemi kaluar nga përafrimi i legjislacionit mes dy vendeve tona dhe me BE-në, në zbatimin e qartë të marrëveshjeve të arritura. Puna jonë dhe sfidat kryesore janë në 4 fusha të mëdha: tregu, shërbimet dhe lëvizshmëria, siguria, kultura dhe diaspora dhe aksioni diplomatik dhe bashkëpunimi politik. Me Kosovën po punojmë fort për krijimin e ekonomisë së përbashkët në rajon, për tregtinë dhe lëvizjen e njerëzve. Pas më se një viti përpjekjeje nënshkruam 'roaming'-un me Kosovën dhe në datën 1 korrik të këtij viti do të ketë efekte reale të tarifave telefonike", - theksoi zëvendëskryeministri Erion Braçe. Homologu kosovar, Fatmir Limaj, u ka lënë ministrave përgjegjës edhe një muaj kohë për të përfunduar punimet dhe të nisin zbatimin e objektivave të përbashkëta. Nën cilësinë koordinatorit të dy qeverive, Limaj tha se mes Shqipërisë dhe Kosovës duhet të realizohen marrëveshjet e bëra në takimin e Pejës. "Ajo që them me kënaqësi është se nga 4 marrëveshjet e mbledhjes së dy qeverive në Pejë ka pasur progres. Duhet të dimë ku jemi me katër marrëveshjet e nënshkruara. Qershori duhet të jetë afati i fundit i fillimit të marrëveshjeve në Pejë. Në këtë aspekt shpresoj që kolegët tanë ministra sot do të njoftojnë për hapat dhe shkallën e 4 marrëveshjeve. Më pas, ne të raportojmë te kryeministri i Shqipërisë dhe kryeministri i Kosovës për të eliminuar pengesat. Duhet t'i japim peshën e duhur dhe të bëjmë një rishikim çfarë kemi bërë deri më tani",-deklaroi z.Limaj.



Zëvendëskryeministri Erjon Braçe

## Lobimi për negociatat, Ruçi, Balla dhe Rudina Hajdari në Holandë

Parlamenti holandez votoi në 16 prill për rikthimin e vizave për shqiptarët, me pretendimin se numri i shqiptarëve të përfshirë në veprimtari kriminale ishte rritur. Për të siguruar një dritë jeshile nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta, kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi po kryen një vizitë treditore në Hagë, me qëllim bindjen e Holandës të votojë pro Shqipërisë. Ruçi sot do ta nisë me një takim me kryetaren e Dhomës së Dytë të Parlamentit holandez, Kadija Arib. Më pas Ruçi dhe delegacioni që e shoqëron atë, kryetari i grupit të PS-së, Taulant Balla dhe kryetarja e grupit demokrat në parlament, Rudina Hajdari do të zhvillojë një seancë dëgjimore me Komisionin e Çështjeve Evropiane, komision i cili do të përcaktojë vendimin e Holandës ndaj Shqipërisë. Të mërkurën, kryetari i Kuvendit do të takohet me kryetaren e Senatit Holandës, Ankie Brokers - Knol dhe me senatorë holandezë. Pavarësisht përpjekjeve të Shqipërisë, Holanda nuk do ta thotë fjalën e saj të fundit përpara se të dalë raporti i KE në 29 maj dhe vendimin përfundimtar do ta shohim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të vendeve të BE-së në 19 qershor, ku nuk përjashtohet skenari që vendimi për Shqipërinë të mos shqyrtohet fare, për t'u shtyrë për në shtator ose dhjetor.

**Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e dyte per pasurine e meposhtme:**

**1-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 5,960 m2 dhe me siperfaqe ndertese 502 m2 me numer pasurie 28/39 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.972 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571,Volumi 15 Faqe 62 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 616,000 (gjashteqind e gjashtembedhjete mije) Euro.**

**2-"Truall "** me siperfaqe 4,730 m2 me numer pasurie 28/70 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.973 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571, Volumi 18 Faqe 143 me adrese Lushnje .
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 185,416 (njeqind e tetedhjete e pese mije e katerqind e gjashtembedhjete) Euro.**

**3-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 2,400 m2 dhe me siperfaqe ndertese 840 m2 me numer pasurie 28/58 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.653 date 25.10.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 15 Faqe 235 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 308,350.56 (treqind e tete mije e treqind e pesedhjete pike pesedhjete e gjashte) Euro.**

**4-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 4,500 m2 dhe me siperfaqe ndertese 1,535 m2 me numer pasurie 28/69 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.431 date 21.06.2013 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 18 Faqe 142 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 884,800 (teteqind e tetedhjete e kater mije e teteqind) Euro.**

**Ankandi do te zhvillohet ne date 12.06.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.**

### ANNOUNCEMENT

**Private Vocational Training Providers in ICT Sector– Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals**

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in ICT sector in the country with the aim to scale-up VET interventions.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **20 May – 20 June 2019**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer training courses in the ICT field. The training duration of each course per batch should be from 1 up to 6 months, maximum.
- The training courses under each contract should target altogether around 50 young unemployed people (19-34 years) in total. There will be a high preference for secondary education graduates. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- In terms of geographical location, priority will be given to Tirana and Durres where the ICT sector is comparatively well-developed. However, if justified based on local labour market needs and employment prospects, proposals in other locations will also be evaluated.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 10 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 40,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 250,000 assigned for this activity is allocated.

**Selection Procedure:**
**First step**: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

**Second Step**: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

**Third Step**: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **20 May – 20 June 2019.**

### "Vrasja ka ndodhur pas largimit për në punë"

# Gruaja i helmoi nënën me fostoksinë, Oltion Lami në gjykatë: Kishin konflikte


Oltion Lami Viktima Lirie Lami

**TIRANË** - Gjykata për Krime të Rënda ka dëgjuar dëshminë e Oltion Lames, në gjyqin që u zhvillua ditën e djeshme ndaj ishbashkëshortes së tij, Marjana Çmeta. Kjo e fundit dyshohet se vrau vjehrrën e saj, Lirie Lami, duke e helmuar me fostoksinë. Gjatë seancës gjyqësore djali i viktimës, Oltioni, dëshmoi mbi ngjarjen, mënyrën se si e mori vesh vdekjen dhe më pas për vrasjen e nënës nga videoja e Hoxhës.

Sipas tij, nëna dhe ishgruaja edhe më herët kanë pas konflikte dhe pikërisht për këto konflikte prindërit kishin ikur nga shtëpia. Oltioni tha se viktima dhe autorja e dyshuar janë zënë më herët edhe fizikisht, ndërsa shtoi se Marjana dyshonte se nëna ndikonte marrëdhënien e tyre. Ditën e ngjarjes, nëna,- tha i riu kishte shkuar te banesa për të çuar qumështin, ndërsa vrasja sipas tij ka ndodhur pas largimit për në punë. Pas tij lidhur me ngjarjen dhanë dëshminë edhe 6 persona të tjerë, të afërt të familjes Lami dhe dëshmitarë okularë, të cilët treguan për momentin se si e kishin gjetur të pajetë Lirie Lamin dhe me shenja në faqen e majtë.

**NGJARJA**

Vrasja ka ndodhur në datën 30 prill të 2017-ës, por vetëm një vit më parë policia arriti ta zbardhë duke arrestuar si autore të krimit 21-vjeçaren, Marjana Çmeta. Në atë kohë, Çmeta ishte tetë muajshe shtatzënë dhe mendonte si e si ta mbyste vjehrrën. Nisur nga marrëdhënia jo e mirë që kishte me Lirien (aso kohe 47-vjeçe dhe mendimi se ishte pikërisht ajo shkaktarja që martesa e saj nuk po shkonte mirë, Marjana kishte thurur një plan që as regjisori më i famshëm nuk do ta kishte menduar. Pas vrasjes ajo është rrëfyer te hoxha, ku ka zbuluar se çfarë ndodhi atë ditë, ndërsa lutej që ajo të vdiste dhe të mos merrej vesh e vërteta. Gjithashtu, në këto biseda, e reja ka treguar se si e joshi vjehrrën ta pinte lëngun me fostoksinë.

### Policia sekuestron 4500 euro që i ishin marrë një pasagjeri të një linje ajrore

# Vidhnin valixhet e udhëtarëve, kapen dy punonjës të bagazheve në Rinas

## *Operacioni "Bagazhi i Fundit", nën hetim edhe dy të tjerë*



**TIRANË**

Dy punonjës të ngarkim-shkarkimit të bagazheve janë ndaluar nga Policia Kufitare e Rinasit, pasi dyshohen për vjedhje të pasurisë nga bagazhet e udhëtarëve. Ndërsa, janë proceduar penalisht në gjendje të lirë edhe dy punonjës të tjerë. Katër personat akuzohen për pesë vjedhje të ndodhura në Aeroportin e Rinasit. Ndërkaq, gjatë operacionit policia ka bërë të mundur sekuestrimin e 4550 eurove të humbura nga një pasagjer i një linje ajrore, i cili kishte bërë denoncim katër ditë më parë. "Në kuadër të zbatimit të detyrave të planit të masave "Për shtimin e masave të sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" Rinas, si dhe nisur edhe nga disa kallëzime dhe ankesa të administruar nga ana e Policisë Kufitare Rinas për vjedhje të pasurisë në bagazhe të udhëtarëve të linjave ajrore, Policia Kufitare e Rinasit ka organizuar punën për goditjen e personave që kryenin këtë veprimtari kriminale. Në bazë të informacioneve të marra me rrugë operative se disa nga punonjësit e sektorit të ngarkim-shkarkimit të bagazheve në vendin e qëndrimit të avionëve në aeroportin "Nënë Tereza"-Rinas, dyshohet se kryenin vjedhje të pasurisë në bagazhet e pasagjerëve të linjave të ndryshme, finalizuan me sukses operacionin policor 'Bagazhi i fundit', thanë burimet policore.

**OPERACIONI**

Sipas këtyre burimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve D.M., 22 vjeç, banues në Tiranë; E.RR., 24 vjeç, banues në Ndroq, Tiranë, për veprën penale të "Vjedhjes në bashkëpunim". Si dhe janë proceduar penalisht edhe shtetasit A.E., 27 vjeç, banues në Mëzez në Tiranë dhe R.H., 27 vjeç, banues në Tiranë, edhe këta punonjës të ngarkim-shkarkimit të bagazheve të pasagjerëve të linjave ajrore. Më datë 17.05.2019, shtetasi H.E. ka kallëzuar në Komisariatin e Policisë Rinas, vjedhjen e një sasie prej 4800 euro në bagazhin e tij të udhëtimit, vjedhje të cilën e ka konstatuar në aeroportin e Lubjanës, Slloveni. Si rezultat i veprimeve operative dhe procedurale të kryera nga Seksioni për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Rinas u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, si dhe gjetja dhe sekuestrimi në cilësinë e provës materiale i shumës prej e 4550 euro, ku dy shtetasit e arrestuar dyshohet se në bashkëpunim me njëri - tjetrin ja kanë vjedhur shtetasit H.E nga bagazhet. Po nga veprimet e kryera dyshohet se shtetasit e mësipërm në bashkëpunim edhe me disa punonjës të tjerë janë autorë të dyshuar edhe në disa raste të tjera vjedhje pasurie dhe konkretisht: Vjedhjes së një sasi vlerash monetare të shtetasit L.J., më datë 15.04.2019; Vjedhjes së një varëseje ari të shtetases A.Z. më datë 24.04.2019; Vjedhjes së një varëseje ari të shtetases D.H., më datë 13.05.2019; Vjedhjes së një sasi vlerash monetare paund shtetasit L.K., më datë 10.03.2019. Në bashkëpunim me Prokurorinë vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të kësaj veprimtarie kriminale në fushën e vjedhjes së pasurisë.

**KALLËZIMI**

Më datë 17.05.2019, shtetasi H.E. ka kallëzuar në Komisariatin e Policisë Rinas vjedhjen e një sasie prej 4800 euro në bagazhin e tij të udhëtimit, vjedhje të cilën e ka konstatuar në aeroportin e Lubjanës, Slloveni. Si rezultat i veprimeve operative dhe procedurale të kryera nga Seksioni për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Rinas u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, si dhe gjetja dhe sekuestrimi në cilësinë e provës materiale i shumës prej e 4550 euro.

**NGJARJA**

## Konflikt mes dy familjeve në Itali, plagoset gruaja shqiptare

**ITALI** - Një konflikt mes dy familjesh në Itali, njëra prej tyre shqiptare, ka degjeneruar deri në përdorimin e armëve. Si pasojë e të shtënave dy persona kanë mbetur të plagosur një prej tyre në gjendje të rëndë. Mediat italiane shkruajnë se marrëdhëniet mes dy familjeve, të cilat jetojnë në Prata Goivine, në Itali ishin tensionuara. Referuar policisë së shtetit fqinj, në sherr e sipër shtetasi italian ka marr armën dhe ka tentuar të qëllojë në drejtim të fqinjit të tij shqiptar, por plumbat kanë kapur gruan e tij, shqiptare si edhe një tjetër shtetas italian, i cili ndodhet në gjendje të rëndë në spital. Fqinjët njoftuan policinë menjëherë pas të shtënave.



### Rinis transporti i parave nga Rinasi, në pistë edhe policia

**TIRANË** - Afro një muaj e gjysmë pas grabitjes spektakolare në pistën e Rinasit, kanë rinisur trasfertat e parave të bankave të nivelit të dytë jashtë Shqipërisë. "News 24" dhe "GSH" ka siguruar një video të makinave të shoqërive private të sigurimit, teksa dorëzojnë ngarkesën e parave në një nga avionët, që është gati për t'u nisur në fluturim. Ndryshe nga më herët ajo që bie në sy është se brenda pistës kanë hyrë punonjësit e policisë, të cilët sikurse shihet në video, janë të armatosur. Dy efektivë të policisë, qëndrojnë në gatishmëri, madje njëri prej tyre flet edhe në telefon, pasi nuk e ka idenë se po filmohet. Pak metra larg avionit, qëndron furgoni i policisë. Prania e forcave të policisë brenda pistës, duket se është një nga masat shtesë të marra nga institucionet me qëllim për të shmangur ngjarje të tjera të rënda siç ishte ajo e 9 prillit, ku një grup kriminal i armatosur depërtoi brenda pistës duke marrë nga barku i një avioni miliona euro, që do të transportoheshin drejt Vjenës. Më herët, policia qëndronte në rrethimin e jashtëm të aeroportit dhe reagonte vetëm kur sinjalizohej nga shoqëria private e sigurisë në Rinas. Në ngjarjen e fundit, policia pas sinjalizimit u vu në ndjekje të grabitësve, ku gjatë shkëmbimit të zjarrit mbeti i vrarë Admir Murataj, një personazh me rekorde kriminale në Greqi e Shqipëri në fushën e vjedhjes së bankave. Pas megagrabitjes brenda aeroportit, që u konsiderua si cenim i sigurisë kombëtare, siguria e Rinasit është marrë në dorë nga ushtria. Pavarësisht masave të marra së fundmi, prokuroria për Krime të Rënda, e cila po heton për ngjarjen e 9 prillit, ende nuk ka dalë ndonjë konkluzion nëse institucionet shtetërore apo kompanitë private, kanë kryer shkelje në përmbushjen e detyrës për garantimin e sigurisë së aeroportit. Dyshimet janë se grupi kriminal ka patur bashkëpunëtor brenda Rinasit, por deri më tani nuk ka ndonjë emër konkret, të jetë marrë person nën hetim apo I pandehur. Ndërkohë lidhur me grabitjen, në pranga janë vënë gjashtë persona, mes të cilëve edhe Alkond Bengasi, që ka marrë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, ndërsa vijojnë të jenë në kërkim Klement Cala, vëllai I tij, Eldi Cala dhe Talo Çela.

Kanabisi nga Shqipëria kalon në pikat kufitare mes Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës

# Raporti: Ballkani, portë e madhe për kokainën që futet nga Amerika e Jugut

## "Janë 40 zona problematike në rajon, Durrësi dhe Bari në Mal të Zi, dy pikat më kyçe"

**AUSTRI**

Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar: "Ballkani ka ende punë për të bërë. Sidomos kur vjen fjala tek lufta kundër krimit të organizuar në rajon, i cili ndryshe nga politika bën bashkë të gjithë grupet kriminale, pa dallim kombësie",-shkruan Deutsche Welle.

Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore, si pjesë e Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, publikoi të hënën (20.05) në Vjenë raportin me të dhënat e mbledhura nga 20 ekspertë dhe gazetarë vendas nga shoqëria civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe në Serbi. Me temën "Zonat problematike të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor", raporti ka si qëllim forcimin e rolit të shoqërisë civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai përmban të dhëna të detajuara mbi qytetet kryesore, zonat bregdetare, pikat kufitare ose nyjet kyçe që janë më të predispozuara për t'u përdorur nga trafikantët e drogës, armëve, qenieve njerëzore, cigareve dhe të tjera veprimtarive kriminale që kryhen në Ballkan.

### HARTA E ZONAVE PROBLEMATIKE TË RAJONIT

Raporti evidenton se krimi i organizuar i përzgjedh vendet ku vepron. Së pari, është pozicioni gjeografik i favorshëm. Ballkani ka vendndodhje strategjike për grupet kriminale që e përdorin atë si tranzit, për të kaluar më pas në tregun e madh dhe fitimprurës të Evropës. Më pas renditet qeverisja e dobët dhe e korruptuar si dhe ekonomia e dobët. "Janë rreth 40 zona problematike që kemi identifikuar. Janë vende si Durrësi në Shqipëri, për shembull, ose Bari në Malin e Zi. Ballkani është kthyer në një portë të madhe për kokainën që futet nga Amerika e Jugut dhe këto dy qytete janë parë si pika kyçe për hyrjen e kokainës në rajon. Një tjetër zonë është pika kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës që quhet Kulla, ku vërehet një numër në rritje i aktiviteteve kriminale, duke nisur nga trafiku i drogës apo kontrabanda e cigareve ndërmjet këtyre dy vendeve. Një tjetër zonë problematike është në pikat kufitare mes Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës, dhe aty kryesisht kalon kanabisi që vjen nga Shqipëria. Është shumë e lehtë të trafikosh kanabis nga njëri shtet tek tjetri, sepse nuk ka shumë kontroll policor dhe nga ana tjetër policitë nuk janë të pajisura me teknologjitë më të fundit që mund t'u mundësojnë gjurmimin e drogave. Gjithashtu, është i pranishëm edhe korrupsioni në radhët e forcave policore dhe një pjesë e konsiderueshme e lehtësirave që u krijohen këtyre veprimtarive kriminale mundësohen edhe nga korrupsioni. Jo vetëm korrupsioni nga policët kufitarë, por edhe në instancat më të larta" - i tha Deutsche Welle-s Fatjona Mejdini, koordinatore në terren e Ballkanit Perëndimor për Iniciativën Globale.

### RIVALË NË POLITIKË, BASHKËPUNËTORË NË TRAFIQE

| 139 | Antoneta | Dede | Kaza | 27.05.2019 14:00 |
| 140 | Antoneta | Tajar | Xhafa | 27.05.2019 14:00 |
| 141 | Antonila | Gani | Hoxha | 27.05.2019 14:00 |
| 142 | Antonjo | Zef | Matija | 27.05.2019 14:00 |
| 143 | Anxhela | Arben | Agaçi | 27.05.2019 14:00 |
| 144 | Anxhela | Ylli | Lezi | 27.05.2019 14:00 |
| 145 | Anxhela | Roland | Lleshi | 27.05.2019 14:00 |
| 146 | Anxhela | Dashamir | Kurani | 27.05.2019 14:00 |
| 147 | Anxhela | Simon | Toska | 27.05.2019 14:00 |
| 148 | Anxhela | Lile | Duro | 27.05.2019 14:00 |
| 149 | Anxhela | Kastriot | Gjineci | 27.05.2019 14:00 |
| 150 | Anxhela | Ylber | Piraj (Tafaj) | 27.05.2019 14:00 |
| 151 | Anxhela | Durim | Biba | 27.05.2019 14:00 |
| 152 | Anxhela | Esat | Hasa | 27.05.2019 14:00 |
| 153 | Anxhela | Shkelqim | Kryemadhi | 27.05.2019 14:00 |
| 154 | Anxhela | Osman | Mançe | 27.05.2019 14:00 |
| 155 | Anxhela | Fadil | Harari | 27.05.2019 14:00 |
| 156 | Anxhela | Lulzim | Mile (Gjokaj) | 27.05.2019 14:00 |
| 157 | Anxhela | Asllan | Lushka | 27.05.2019 14:00 |
| 158 | Anxhela | Ylli | Shtembari | 27.05.2019 14:00 |
| 159 | Anxhela | Filip | Qori | 27.05.2019 14:00 |
| 160 | Anxhela | Elmas | Caci | 27.05.2019 14:00 |
| 161 | Anxhela | Guri | Gora | 27.05.2019 14:00 |
| 162 | Anxhela | Birce | Tojalli | 27.05.2019 14:00 |
| 163 | Anxhela | Bujar | Avdiraj | 28.05.2019 09:00 |
| 164 | Anxhela | Selman | Alickaj | 28.05.2019 09:00 |
| 165 | Anxhela | Vaid | Shehi | 28.05.2019 09:00 |
| 166 | Anxhela | Fatmir | Shehaj | 28.05.2019 09:00 |
| 167 | Anxhela | Leonard | Ranxha | 28.05.2019 09:00 |
| 168 | Anxhela | Vladimir | Musaku | 28.05.2019 09:00 |
| 169 | Anxhela | Nezi | Nezhaj | 28.05.2019 09:00 |
| 170 | Anxhela | Albert | Sako | 28.05.2019 09:00 |
| 171 | Anxhela | Çlirim | Trashi | 28.05.2019 09:00 |

DITA E JETIMËVE
PROBLEMATIKAT

Voltiza Duro

I riu i rritur në fshatin 'SOS' rrëfen përpjekjet për të arritur suksesin

# Alfred Muharemi: Shteti i ka braktisur jetimët për herë të dytë

## "Ndihma ekonomike, vetëm 30 mijë lekë të vjetra"




**STUDIMET**
Kam përfunduar studimet e larta për ekonomik me rezultate të shkëlqyera dhe sot punoj në një bankë e për të gjitha arritjet e mia i jam mirënjohës mbështetjes së fshatit 'SOS'. Unë finalizova dashurinë time me Erjonën në ambientet e fshatit 'SOS' në Tiranë në 23 qershor 2017, pra ditën e lindjes së themeluesit të 'SOS', Kinderdorf International Z. Hermann Gmeiner.

**PROBLEMATIKAT**
Për fëmijët pa kujdes prindëror, shteti është e vetmja familje që për fat të keq nuk e ka luajtur rolin e tij për të ofruar kujdesin dhe sigurinë e duhur. Në vitin 1996 u hartua edhe miratua ligji 8153 "Për Statusin e Jetimit" për të sanksionuar institucionet publike apo ato private për integrimin edhe mbrojtjen e fëmijëve jetimë.

Rreth 31 mijë fëmijë në vendin tonë nuk e kanë mundësinë të jenë nën kujdesin prindëror. Por përveç mungesës së prindërve, një sërë problematikash të tjera janë shoqëruesit e jetës së përditshme të jetimëve në Shqipëri. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Alfred Muharemi një i ri që ka jetuar për vite me radhë në fshatin SOS, tregon vështirësitë që ka hasur, mungesën e dashurisë prindërore si dhe finalizimin me sukses të ëndrrave të tij. Më tej ai tregon nismat që ka ndërmarrë për të ndihmuar jetimët si dhe evidenton problematikat kryesore e mospërkrahjen nga shteti për këtë kategori.

**Ju keni jetuar në shtëpinë e fëmijës në Shkodër e më vonë jeni transferuar në fshatin SOS. Mund të na tregoni si kanë qenë kushtet dhe përkujdesja që keni marrë gjithë këto vite?**

Fillimisht kam jetuar në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër që për hir të së vërtetës nuk e njohëm kurrë si institucion pasi nuk e kishte rolin edukativ edhe të mirërritjes, fëmijët ishin vazhdimisht objekt i dhunës verbale dhe fizike, ndërsa në moshën 5-vjeçare u transferova në Fshatin SoS, ku kam qëndruar për rreth 18 vite nën kujdesin e institucionit. Dua të theksoj se në fshatin SOS, kam marrë shumë dashuri, kujdestaret që u bënë nëna tregonin përkujdesje, dhembshuri e profesionalizëm. Koncepti familje ishte baza e funksionimit të çdo programi në SOS. Kushtet e shtëpisë ku jetonim ishin shumë të mira dhe të garantonin siguri.

**Çfarë iu ka munguar më shumë gjatë gjithë viteve në këtë institucion?**

Mendoj se mungesa më e madhe për çdo fëmijë apo edhe të ri në SoS është mungesa e dashurisë prindërore, e cila pavarësisht çdo kujdesi dhe dashurie tjetër është e pazëvendësueshme.

**Ku i keni kryer studimet dhe ku punoni aktualisht?**

Kam përfunduar studimet e larta për ekonomik me rezultate të shkëlqyera dhe sot punoj në një bankë e për të gjitha arritjet e mia i jam mirënjohës mbështetjes së Fshatit SoS. Unë finalizova dashurinë time me Erjonën në ambientet e Fshatit SoS në Tiranë në 23 qershor 2017, pra ditën e lindjes së themeluesit të SoS Kinderdorf International Z. Hermann Gmeiner. Ky njeri ndryshoi gjithë jetën time dhe sot më bën krenar të them me plot gojë që jam i lumtur që jam i Ri SoS. Gjithashtu, ishte edhe dëshira që një ditë oborri i shtëpisë sime në SoS të ishte i mbushur plot me njerëzit, të cilët kishin kontribuar për formimin tim si karakter, vlerat e fituara dhe mbështetjen në edukim duke i vlerësuar pa diskutim si personat më human dhe më të rëndësishmit në jetën time për të cilin unë jam sot.

**Ju jeni një ndër personat që ndër gjithë këto vite keni luftuar për të drejtat e jetimëve. Cilat janë disa nga problematikat që jetimët hasin në Shqipëri?**

Për fëmijët pa kujdes prindëror, shteti është e vetmja familje që për fat të keq nuk e ka luajtur rolin e tij për të ofruar kujdesin dhe sigurinë e duhur. Në vitin 1996 u hartua edhe miratua ligji 8153 "Për Statusin e Jetimit" për të sanksionuar institucionet publike apo ato private për integrimin edhe mbrojtjen e fëmijëve jetimë. Një ligj që për hir të së vërtetës nuk ka njohur asnjë ndryshim që prej miratimit të saj por edhe ka shkaktuar problemin më të madh të mos përfshirjes së 93% të tyre (atyre të fëmijëve me një prind). Në vendin tonë ka institucione të përkujdesjes shtetërore dhe private për fëmijët pa kujdes prindëror dhe e tmerrshme si po aq e dhimbshme është përballja e një të riu jetim pasi del nga kujdesi institucional në moshën 18-vjeçare ku orientohet drejt një rruge të pa njohur dhe pa kthim...I pa mbështetur ekonomikisht, i pa arsimuar, i pa punë edhe i strehuar përkohësisht në godinat studentore që nuk përmbushin kushtet minimale të jetesës.

**Sa është ndihma ekonomike që ofron shteti shqiptar për jetimët?**

Unë, si përfaqësuesi i zgjedhur nga të rinjtë pa kujdes prindëror dua të theksoj se ndihma ekonomike që ofron shteti për jetimët është rreth 3 mijë lekë të reja në muaj. Edhe pas 29 viteve, kjo kategori nuk është integruar plotësisht pasi sot kemi pafund të rinj jetimë, të cilët enden zyrave të punësimit edhe nuk arrijnë të gjejnë një punë; enden zyrave të pushtetit lokal për bonuset e qirave dhe ofrimin e banesave sociale, por pjesa më e madhe e tyre refuzohen pasi janë të papune. Pra, e ardhura e vetme e këtyre të rinjve është 3 mijë lekë ndihmë ekonomike që nuk mbulon kushtet më minimale të jetesës. Kjo gjë vjen si pasojë të mosfunksionimit të ligjit "Për Statusin e Jetimit".

**Sa e sigurt dhe e mbrojtur nga shteti ndihet kjo kategori?**

E sigurt edhe e mbrojtur aspak ndër këto vite... Miliona dollarë të shpenzuar për edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve pa kujdes prindëror nuk i ka shërbyer shoqërisë. Shteti i ka braktisur për herë të dytë!!! Pra, kjo është panorama e pasigurisë dhe rreziqeve që shoqëron çdo anëtar të kategorisë së jetimëve gjatë gjithë jetës, ku ligji ngarkohet t'u garantojë të drejta, mbështetje edhe suport por që në jetën e përditshme asnjë nen i tij nuk gjen zbatueshmëri. Jetimët në Shqipëri përpos mungesës së kujdesit nga ana e strukturave shtetërore ajo që kanë ndjerë në kurrizin e tyre për fat të keq më së shumti është edhe lufta e ashpër e organizatave të shoqërisë civile ku në plan të parë vendosin interesat e tyre personale. Mos përfaqësimi i duhur për të përçuar zërin e tyre në zgjidhjen e problematikave që hasin në jetën e përditshme e ka theluar edhe më shumë gjendjen e tyre.

**A keni kërkuar të drejtat tuaja pranë instancave përgjegjëse?**

Ne kemi kërkuar pafund amendime në ligj për zgjerimin e përfituesve pasi numri më i madh është i fëmijëve dhe të rinjve jetimë me një prind ku Statusi është vetëm për jetimët biologjikë ose kur kujdestaria nuk është për asnjë nga prindërit. Kemi kërkuar ofrim falas të studimeve pasuniversitare për të rinjtë jetimë, masa e ndihmës ekonomike të jetë në vlerën 10.000 lekë si dhe strehimin e detyrueshëm nga shteti për këtë kategori.

**Ju vetë si i vini në ndihmë fëmijëve jetimë?**

Prej shumë vitesh kam marrë iniciativën me një grup të rinjsh të rritur po në SoS, apo dhe në shtëpitë e fëmijës në Tiranë dhe Shkodër për të ofruar mbështetjen tonë për brezat më të vegjël e për fëmijët pa kujdes prindëror. Aktualisht janë rreth 31 mijë fëmijë jetimë në gjithë Republikën e Shqipërisë. Projektet tona kanë qenë me mbështetje ekonomike dhe sociale. Sot unë mund të përmend rreth 32 projekte si lokale dhe kombëtare (falë pushtetit lokal, institucionit të presidencës, komunitetet fetare, bizneseve dhe individëve të ndryshëm) në mbështetje të fëmijëve pa kujdes prindëror. Kemi arritur të organizojmë evente të ndryshme për këtë kategori, por edhe asistim në marrëdhënie pune, ofrimin e studimeve me bursë sociale etj.

Dua të ndaj me ju nismën më të rëndësishme që së bashku me Kongresin Rinor Kombëtar, Shoqatën Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë, Organizata Liburnetik me znj. Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentit për të ratifikuar dhe ndryshuar plotësisht ligjin 8153 "Për Statusin e Jetimit" ku do të integroje realisht të gjithë fëmijët pa kujdesin prindëror. Kjo vetëm falë znj. Spiropali, e cila po e mbështet vazhdimisht këtë kategori.

**Gjatë këtyre viteve keni fituar disa çmime të rëndësishme. Mund të na tregoni më specifikisht pse iu janë akorduar këto çmime?**

Çmimet që mua më kanë akorduar janë Çmimi i Filantropisë si Individ për Vitin 2018 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim edhe Zhvillim si dhe Çmimin e tretë në Konkursin "Pse dal vullnetar" nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri në kuadër të Javës së Evropës 2019.

Këto çmime ua dedikoj SoS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, familjes sime dhe të gjithë individëve, subjekteve, organizatave, trupat diplomatike që më kanë mbështetur pafund në ëndrrën time "integrimin real" të fëmijëve pa kujdes prindëror në Shqipëri.

### Rrëfehet regjisori: Puna 2-vjeçare për filmin, ja pritshmëritë

# Marius Dervishi:

## "Sedër", një mesazh i fortë për shoqërinë shqiptare

### "Nuk kam pengje, kam qenë realist në ëndrrat e mia"

Egla Xhemali

Një film me përmasa gjigante shumë shpejt do të trokasë në dyert e kinemave shqiptare. Filmi është i zhanrit komedi, dramë dhe aksion dhe do të prezantohet për publikun në fund të qershorit. Filmi titullohet "Sedër" dhe është i ndarë në dy pjesë. Ndërkohë që do të prezantohet pjesa e parë në kinema, do të nisë puna për pjesën e dytë, që duket se do të jetë me nota të forta aksioni dhe se do realizohet jashtë Shqipërisë. Regjisori Marius Dervishi vjen në një rrëfim për "Gazeta Shqiptare", për të ndarë me ne punën e madhe këto dy vitet e fundit, si dhe për të na treguar detaje nga jeta përtej regjisë. Gjithçka zë fill nga zënka e dy fëmijëve, për të implikuar më pas edhe prindërit. Hakmarrja në film nuk vjen si plagë e mentalitetit, por si diçka që e imponon sedra për të rifituar dashurinë e fëmijës. Filmi ka mesazhe mjaft të forta për shoqërinë shqiptare dhe përfshin të gjitha grupmoshat. Mariusi luan rolin e njërit prej prindërve që bëhet pre e lëndëve narkotike, duke zhgënjyer kështu të birin. Më tej, teksa del nga petku i profesionit, Mariusi thotë se nuk kursehet kurrë për vepra të mira dhe se nuk ka pengje nga rrjedha e kohës.





**Sa e vështirë është të kombinosh dramën, komedinë dhe aksionin në një film?**

Në fakt, është shumë e vështirë, sepse me këto 3 elemente të gërshetuara bashkë synohet të "luhet" me emocionet e shikuesit, gjë kjo që e bën filmin të marrë edhe pak nuanca të trillerit.

**Hakmarrja që lind si pasojë e zënkës mes fëmijëve, ka në thelb diçka nga e kaluara jonë?**

Kjo nuk është hakmarrje si pasojë e mentalitetit apo rregullave të Kanunit. Realisht në këtë "hakmarrje" nuk është se ka një motiv të mirëfilltë, por çdo gjë nis si pasojë e "sedrës" si dhe dëshirës së madhe për të bërë diçka për të rifituar dashurinë e të birit.

**Për ata që ende nuk e dinë , si zhvillohet ngjarja në film? Na zbuloni disa detaje.**

Filmi nis te zënka e dy fëmijëve, të cilët kanë fatin e keq të jenë të dy pa nëna. Albi duke u ndier i ofenduar dhe nga mësuesja, ikën në shtëpi t'i tregojë të atit, të cilit e konsideronte si hero. Te shkolla kemi përplasjen e dy prindërve, por në momenti që Roni (i ati i Albit) sheh përmasat fizike të Sokolit (babait të Flavios) tërhiqet nga qëllimi fillestar për të goditur fëmijën e Sokolit dhe duke tentuar të dalë nga situata, godet djalin e vet. Këtu Albi fillon të shikojë me nënvlerësim të atin dhe Roni duke parë mërinë e të birit si dhe duke u ndikuar nga përdorimi i lëndëve narkotike i fiksohet në kokë "hakmarrja". Duke dashur shumë të bënte diçka për të fituar dashurinë e të birit, Roni detyrohet të punojë në pazare të pista, gjë që e bën të kalojë shumë peripeci.

**Cila është skena që ka pasur më shumë dubla?**

Skena që ka pasur më shumë dubla ka qenë një skenë filmike te shkolla. Ishte një pjesë komike e zënkës që zhvillon Roni me rojën e shkollës dhe me një djalë që shet trëndafila.

**Momenti më qesharak gjatë xhirimeve?**

Në fakt ka shumë momente qesharake, pasi i tillë është edhe filmi.

**Ju si regjisor keni pasur rolin e Ronit. Cila është e veçanta e këtij personazhi?**

Roni është personazh i varur nga përdorimi i lëndëve narkotike dhe në vetvete ky si personazh mbart një mesazh goditës për çdo njeri apo baba që mendon që jeta e tij ka marrë fund. Është pikërisht Roni, djali i rrugës dhe i varur nga lëndët narkotike, ai që edhe pse mendon që s'ka ndjenja për njeri, detyrohet t'u zhytet problemeve vetëm për të fituar dashurinë e të birit duke sakrifikuar kështu edhe jetën e tij.

**Filmi prezantohet në fund të qershorit. Cilat janë pritshmëritë tuaja?**

Pritshmëritë tona normalisht që janë të mëdha. Kemi punuar shumë për këtë projekt dhe mendoj që me ato personazhe të përfshirë në film, çdo shqiptar duke filluar nga mosha 17 deri në moshat e treta do e gjejnë veten të përfshirë. Është film që ka shumë komedi dhe nëpërmjet komedisë jemi munduar të përcjellim shumë mesazhe për shoqërinë shqiptare.

**Përtej petkut të regjisorit, çfarë jete bën Mariuesi? Angazhimet tuaja përtej filmit?**

Nuk është se jam marrë me ndonjë angazhim tjetër që prej 2 vitesh. I jam përkushtuar këtij projekti dhe krahas këtij, jam marrë edhe me video komike në "Instagram", duke arritur një audiencë prej 110 k ndjekës brenda vitit.

**Për çfarë nuk kurseheni kurrë?**

Nëse flasim për kursime monetare, nuk kursehem kurrë për ushqimin. E nëse flasim në tërësi, kurrë nuk kursehem në ofrimin e ndihmës dhe suportin që u jap miqve të mi apo çdokujt që ka nevojë, qoftë edhe për disa fjalë motivuese.

**Pengu më i madh që keni nga rrjedha e kohës?**

Nuk kam pengje deri tani, sepse kam qenë realist në ëndrrat e mia. Shpresoj që të mos kem ndonjëherë. (qesh).





## "Ditët e fundit në 'Top Channel'", Arbana Osmani bën deklaratën bombë



Arbana Osmani është një nga moderatoret më të dashura për publikun shqiptar. Kohët e fundit ajo ka qenë shpesh në vëmendjen e medi-ave për lidhjen me regjisorin e emi-sionit "Dua të të bëj të lumtur", Eduart Grishaj. Të shtunën që lamë pas, moderatorja deklaroi se këtë javë është episodi i fundit i emision-it "Dua të të bëj të lumtur". Nuk dihet nëse moder-atorja po e brak-tis përgjithmonë "Top Channel", apo e ka thënë këtë pasi po përfundon një tjetër sezon të emisionit të saj. Në postimin e saj të fundit në llogarinë e saj të "Instagram"-it, ka postuar një foto ku shihet e veshur me një fustan portokalli, por ajo që na bën përshtypje është përshkrimi që ka lënë anash fotos: "Ditët e fundit në 'Top', e lodhur por e lumtur", - shkruan Arbana.

## I thanë se është plakur, këngëtarja e njohur na habiti me reagimin e saj

Anxhela Peristeri është padyshim një nga këngëtaret më të mira të tregut muzikor. Ajo ka shumë vite në skenë dhe shumë prej këngëve të saj janë kthyer në hite, të cilat vazhdojnë të pëlqehen shumë edhe sot. Peristeri ka sjellë një sërë projektesh kohët e fundit. Anxhela ka qenë mjaft aktive edhe në rrjetet sociale. Në postimet e saj në "Instagram" shihen shumë komente, të cilat kanë të bëjnë me moshën e saj dhe kjo gjë e ka shtyrë këngëtaren që të flasë një herë e mirë për këtë gjë. "Për të gjithë ata që më shkruajnë sa vjen e rinohesh, ose që ngatërrohen me moshën time për shkak të viteve të shumta në skenë, jam 33 vjeçe dhe as jam rinuar e as jam plakur, jam thjesht në lule të moshës. Ju dua shumë!", - ka shkruar Anxhela.






## Më seksi se kurrë në foton e fundit, mirëpo ja çfarë i ka ndodhur Marina Vjollcës

Marina Vjollca është padyshim një nga personazhet më përfolur në "show bizz"-in shqiptar. Së fundmi, ajo bashkë me bash-këshortin e saj Getoar dhe të motrën Luanën kanë vendosur që të bëjnë disa pushime në Venecia, Itali. Moderatorja ka publikuar shumë foto nga ky qytet dhe një nga ato që tërhoqi vëmendjen ishte fotoja ku ajo u shfaq si "Gruaja Mace". E veshur e gjitha me lëkurë të zezë nga koka te këmbët ngjan shumë shik, por ajo që ka tërhequr vëmendjen e fansave janë këmbët e saj. Pozicioni i tillë në shkallët e hotelit ka bërë që Marina të duket sikur ka nxjerrë kaviljen nga vendi, duke i trembur fansat: "Shpresojmë mos t'i kesh këmbët kësh-tu në të vërtetë se s'është normal", i shkruan një ndjekës. "Kavilja e këmbës i di vuajtjet e kësaj fotoje mahnitëse", është komenti i radhës. "Desh t'u thye këmba", vijon një tjetër.



## Keisi largohet nga Shqipëria, kush është mashkulli që po e shoqëron?

Bashkëshortja e këngë-tarit të njohur Arki-mend Lushaj, i njohur ndryshe si Stresi, ka bërë disa postime në llogarinë e saj të "Instagram"-it, duke na treguar se është larguar nga Shqipëria. Siç e dimë të gjithë, u bënë disa muaj që Stresi vazhdon të qëndrojë në burg dhe përveç dediki-meve që ajo i bën herë pas here atij, lidhja e tyre ka qenë edhe më e fortë këtë periudhë që çifti po përje-ton një marrëdhënie në distancë, ndërsa Keisi ka treguar se ajo është një nga mbështetjet më të mëdha të reperit. Por më shumë çudi na bën cili është personi që po e shoqëron në këtë udhëtim?! Bukuroshja është nisur sërish drejt Kanadasë ku jeton dhe në disa video ajo shfaqet duke bërë gëzuar me një mash-kull që ndodhet pranë saj. Për një çast na bëri të mendojmë se Keisi sho-qërohet nga Stresi në udhëtimin e saj dhe shpresojmë që kjo të jetë e vërtetë!



### Kryeministri kosovar: Ne përmbushim kriteret e nevojshme për këtë proces

# Haradinaj: Urime Kosovë! Gjermania konfirmon mbështetjen për vizat

## "Komisioni i BE-së konfirmoi se ka përmbushur të gjitha kërkesat"

Ditën e djeshme, kryem inistri i Kosovës, Ra mush Haradinaj, ka thënë se Gjermania edhe njëherë e konfirmon mbështetjen për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në një status në "Facebook", Haradinaj ka shkruar se mbështetja e ministrit të Brendshëm të Gjermanisë, Seehofer për procesin e liberalizimit të vizave, duke e konsideruar të justifikueshme kërkesën e kosovarëve për të lëvizur të lirë dhe duke këmbëngulur që Kosova përmbush kriteret e nevojshme për këtë proces. "Gjermania edhe njëherë konfirmon mbështetjen e Kosovës për liberalizimin e vizave. Në publikimin e radhës të FAZ, theksohet mbështetja e ministrit të Brendshëm të Gjermanisë, Seehofer për procesin e liberalizimit të vizave, duke e konsideruar të justifikueshme kërkesën e kosovarëve për të lëvizur të lirë dhe duke këmbëngulur që Kosova përmbush kriteret e nevojshme për këtë proces. Një mbështetje të madhe këtij procesi i ka dhënë edhe deputeti i Partisë së Gjelbër Manuel Sarrazin, derisa në korrik të 2018-tës, Komisioni i BE-së konfirmoi se Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat, e po të njëjtin vlerësim vendi e mori edhe nga Parlamenti Europian. Tani Kosova ka krijuar ekipin e saj për të bashkëpunuar me qeverinë gjermane, që ky proces të finalizohet sa më parë. Kosovarët, tashmë e kanë marrë PO-në e madhe nga Gjermania, për ta jetësuar të drejtën e tyre për lëvizje të lirë. Urime Kosovë", ka shkruar në 'Facebook', Ramush Haradinaj. Ndërkaq, nga ana tjetër, ekspertët e integrimit evropian vlerësojnë se këtë vit mund të merret vendimi për heqjen e vizave për kosovarët me Bashkimin Evropian, mirëpo gjasat e mëdha janë që vendimi të shtyhet prej 1 korrikut 2019, përkatësisht pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian të planifikuara për në maj 2019. Edhe pse para tetë vjetësh (2010) krerët e institucioneve të Kosovës nisën zotimet për liberalizimin e vizave, një gjë e tillë ende nuk është realizuar. Përkundrazi, Kosova aktualisht është në pritje të publikimit të rekomandimit të Komisionit Evropian (KE), i cili do të tregojë nëse është përmbushur kriteri i luftës ndaj krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha është shprehur optimiste se liberalizimi i vizave do të finalizohet përgjatë këtij viti. Sipas saj, rekomandimi do të jetë pozitiv dhe do të publikohet më së largu në javën e parë të muajit të ardhshëm (korrikut). Por ekspertët e procesit të integrimit konsiderojnë se gjasat janë shumë të vogla që liberalizimi të ndodhë përgjatë këtij viti. Madje, siç thonë ata, po qe se rekomandimi i KE-së vonohet të publikohet edhe më tej Kosova rrezikon të mos e marrë liberalizimin as në gjysmën e parë të vitit tjetër. Ky rekomandim i cili do të tregojë përfundimisht nëse Kosova e ka përmbushur ose jo kriterin e fundit për viza, siç ka thënë ajo do të publikohet në fillim të këtij muaji ose në fillim të muajit që vjen. "Rekomandimi pritet të dalë qoftë në ditët e fundit të qershorit ose në fillim të korrikut, për shkak të punimeve të këtij samiti që ka filluar sot në Bruksel. Presim të dalë pozitiv, është çështje ditësh dhe do të jetë para pushimeve të verës. Ky është vetëm hapi i parë i procesit të vendimmarrjes",-ka deklaruar ajo gjatë një konference për media. Pas publikimit të rekomandimit, siç ka njoftuar Hoxha, ai do të miratohet në Komitetin për të Drejtat Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në Parlamentin Evropian (LIBE) më së largu deri më 11 korrik. "Komisioni LIBE ka disa afate ku do të takohet, është një afat më 11 korrik, ku ne po synojmë dhe jemi duke lobuar që këto data të përputhen, që vendimi në LIBE të merret para pushimeve të verës. LIBE ka takim më 11 korrik dhe aty presim të miratohet", ka theksuar ajo. E para e MIE-së më tej është shprehur optimiste se procesi i liberalizimit do të finalizohet deri në fund të këtij viti. "Zgjedhjet për PE-në e vështirësojnë vendimmarrjen për vizat." Kështu është shprehur Jehona Lushaku, njohëse e procesit të integrimit, e cila ka vlerësuar se ka gjasa që liberalizimi të ndodhë këtë vit nëse ka vullnet politik prej shteteve që janë anëtare të BE-së. Por sipas saj, për shkak të disa problemeve që ekzistojnë brenda BE-së, vendosja e vendimit mund të shtyhet për vitin tjetër, edhe nëse vendimi merret këtë vit. "Në anën tjetër BE-ja ka edhe disa probleme me migracionin, me politikat e saj ndaj migracionit, ndaj menaxhimit të zgjedhjeve për vitin e ardhshëm. Kosova është një vend me potencial migrimi, pastaj politikanët brenda shteteve të BE-së llogarisin që kjo mund t'u kushtojë politikisht. Nën këtë llogari politike gjasat janë që procesi dhe vendimi të merret këtë vit, e vendosja të shtyhet pas zgjedhjeve, më 2019", ka deklaruar ajo. Në tërë këtë proces, sipas Lushakut, rol të madh luan edhe fakti se sa lobojnë politikanët kosovarë dhe sa i garantojnë ata shtetet e BE-së se nuk do të ketë valë migracioni në BE. Ndërkohë ka vlerësuar se liberalizimi ka mundur të ishte përfunduar tashmë, por politika kosovare e ka shfrytëzuar jo mirë kohën. Sipas saj, tre vjet nuk është diskutuar fare për liberalizim, pasi tre vjet i ka marrë vetëm demarkacioni. "Nëse vonohet rekomandimi mund të mos ketë liberalizim as më 2019-n" Kështu është shprehur profesori i së Drejtës Evropiane, Emrush Ujkani, i cili ka thënë se mospublikimi i tij në qershor (siç ishte paraparë) e zbeh optimizmin se liberalizimi mund të përmbyllet shpejt. "Pritshmëritë kanë qenë të tilla te një pjesë e mirë e opinionit se rekomandimi do të ndodhë në fund të këtij muaji. Mirëpo, kur unë e kam parë që nuk po ndodh deri në fazën kur nuk ndodhi, nuk kam qenë edhe optimist. Optimizmi ka shkuar duke rënë dhe mendoj që tash jemi në një fazë ku ende flasim për rekomandim dhe nuk flasim për vendimmarrje",-ka deklaruar ai. Sipas tij, vonesat në publikimin e rekomandimit mund të ndikojnë edhe te përmbyllja e këtij procesi. "Komisioni Evropian mund ta bëjë këtë në çdo kohë. Mund ta ketë bërë këtë javë, mund ta bëjë në fillim të muajit korrik. Varësisht nga koha dhe sa do të vonohet dhënia e rekomandimit, do ta ketë ndikimin e vet në procesin e vendimmarrjes, sepse një vendimmarrje në BE është goxha e ngarkuar dhe minimumi janë 5-6 muaj që Këshilli dhe Parlamenti duhet t'i kenë në dispozicion për ta marrë një qëndrim", ka shtuar ai. Nëse rekomandimi vonohet edhe më tej (pas fillimit të korrikut), sipas tij, liberalizimi mund të mos ndodhë pastaj as në vitin tjetër, pasi do të mbahen zgjedhjet për PE-në. "Jo vetëm që të mos ndodhë këtë vit, por tani do të jetë e vështirë të ndodhë edhe vitin që vjen. Megjithatë, ende jemi mirë me kohën, në qoftë se Komisioni Evropian do të mundë që deri në fillim të korrikut të vijë me një rekomandim të tillë",-ka pohuar Ujkani. Ndërkaq profesori i së Drejtës Ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka konsideruar se rekomandimi i KE-së do të jetë pozitiv për Kosovën, pasi Kosova tashmë ka përmbushur të gjitha kriteret e vëna për liberalizim. "Por nuk do të befasohesha në të njëjtën kohë, ndoshta për shkak të përbërjes së BE-së, që të ketë vendim për ta shtyrë këtë proces. Disa vende vazhdojnë ta mbajnë pozicionin kundër pavarësisë së Kosovës dhe është e mundur që kjo të shprehet edhe në rekomandimin pozitiv për viza. Por, megjithatë jam optimist se rekomandimi do të jetë pozitiv", ka deklaruar Hoti. Sipas tij, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, që është kriteri i fundit për këtë proces, mbetet sfidë edhe pas finalizimit të procesit të vizave. "Ajo është luftë që do të reflektohet në vazhdimësi, edhe pas liberalizimit. Madje edhe vendet që janë anëtare të BE-së vazhdojnë ta luftojnë korrupsionit, sepse është një fenomen që përcillet dhe në këtë fazë mund që ato shtete, të cilat nuk janë krejt të gatshme të jenë për liberalizimin ta përdorin këtë argument që gjoja Kosova nuk e ka plotësuar kriterin e luftës kundër korrupsionit", ka shtuar ai. Tanimë të shohim se çdo të ndodhë pas zgjedhjeve të KE dhe më pas vendimit që do të merret në korrik për Kosovën.


Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

### STATUSI I HARADINAJT

"Gjermania edhe njëherë konfirmon mbështetjen e Kosovës për liberalizimin e vizave. Në publikimin e radhës të FAZ, theksohet mbështetja e ministrit të Brendshëm të Gjermanisë, Seehofer për procesin e liberalizimit të vizave, duke e konsideruar të justifikueshme kërkesën e kosovarëve për të lëvizur të lirë dhe duke këmbëngulur që Kosova përmbushë kriteret e nevojshme për këtë proces. Një mbështetje të madhe këtij procesi i ka dhënë edhe deputeti i Partisë së Gjelbër Manuel Sarrazin, derisa në korrik të 2018-tës, Komisioni i BE-së konfirmoi se Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat, e po të njëjtin vlerësim vendi e mori edhe nga Parlamenti Europian. Tani Kosova ka krijuar ekipin e saj për të bashkëpunuar me Qeverinë gjermane, që ky proces të finalizohet sa më parë. Kosovarët, tashmë e kanë marrë PO-në e madhe nga Gjermania, për ta jetësuar të drejtën e tyre për lëvizje të lirë. Urime Kosovë", ka shkruar në 'Facebook', Ramush Haradinaj.

### Kryeministri grek synon tjetër mandat në zgjedhjet e tetorit

## Cipras, kusht Shqipërisë: Rruga e BE-së, e mbyllur nëse s'mbron të drejtat e minoritarëve



Në marrëdhëniet Shqipëri-Greqi dhe formulën që duhet ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të hapura, është referuar kryeministri grek në intervistën e ditës së diel për "Financial Times". Aleksis Cipras ka transmetuar mesazhe në të gjitha drejtimet, duke u shprehur qartë se synon në një tjetër mandat qeverisje në zgjedhjet e sivjetshme parlamentare, që do të kryhen brenda afatit të 20 tetorit 2019. Cipras është referuar gjatë në këmbënguljen e kabinetit të tij për zgjidhjen e çështjes së Maqedonisë Veriore, duke rrëfyer se ishte i vendosur të ulte të dy palët në tryezë dhe të arrinte një marrëveshje. Kryeministri grek e konsideron një marrëveshje të balancuar e një arritje tepër të suksesshme, përderisa marrëdhëniet e normalizuara me fqinjët veriorë zgjerojnë hapësirën e investimeve dhe ekonominë e rajonit. Hapi tjetër i logjikshëm do të jetë zgjidhja e çështjeve të hapura me Shqipërinë, në pritje nga dialogu premtues i nëntorit të vitit 2017. "Financial Times" përcakton çështjet e pazgjidhura në atë të kufijve detarë, abrogimin e ligjit të luftës nga viti 1945 dhe minoritetin grek në Shqipëri. Aleksis Cipras ka deklaruar se i ka bërë të qartë kryeministrit Edi Rama se Tirana duhet të mbrojë plotësisht të drejtat e minoritarëve grekë, në rast të kundërt rruga drejt BE do të mbyllet. Nëse Shqipëria përmbush detyrimet për të drejtat e njeriut, thotë Cipras "Greqia - dhe unë personalisht - do të mbështesim një vendim të mundshëm në qershor për çeljen e negociatave për dy vendet, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut së bashku. Por ne nuk do të rrezikojmë çeljen e negociatave për Maqedoninë e Veriut, nëse ky vend ka arritur progresin e duhur. Kjo do të ishte e padrejtë!". Tsipras ka theksuar se Greqia nuk dëshiron të fitojë reputacionin e lektorit, duke treguar fuqinë apo duke përcaktuar kushte të ngurta për vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE. Ndërkohë që ka theksuar se "popujt e Ballkanit kanë nevojë për një nxitje të realizimit të reformave". Tsipras është referuar dhe në betejën e madhe elektorale që po kryen për arritjen e një mandati të dytë në zgjedhjet parlamentare si dhe në reformat e fundit në favor të rritjes së ekonomisë dhe zhvillimit të Greqisë.

## BE i kërkon sqarime Serbisë për ndalimin e zyrtarëve nga Kosova

# Këshilltari i Haradinajt: Po shkelin marrëveshjen e Brukselit për lëvizje të lirë

Zyrtarët e institucioneve të Kosovës që i takojnë Partisë së Pavarur Liberale, subjekt ky politik i komunitetit serb, prej disa muajsh me radhë janë duke u ndaluar në vendkalimet kufitare Kosovë-Serbi nga ana e strukturave të sigurisë së Serbisë. Rasti i fundit është shënuar më 11 maj të këtij viti, kur autoritetet e Serbisë, në vendkalimin kufitar Dheu i Bardhë, i kanë ndaluar anëtarët e Partisë së Pavarur Liberale, Srećko Spasic dhe Srgjan Jovanoviç. Ky i fundit është këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Ndaj ndalimit të zyrtarëve të institucioneve të Kosovës të komunitetit serb, ka reaguar edhe kryeministri Haradinaj, i cili e ka cilësuar si të papranueshëm këtë akt. Ndërkaq, këshilltari i kryeministrit Haradinaj, Halil Matoshi, thotë



se ndalimi nga strukturat e sigurisë së Serbisë të pjesëtarëve të komunitetit serb, që janë pjesë e institucioneve qendrore të Kosovës, është jo vetëm shkelje e Marrëveshjes së Brukselit për lëvizje të lirë, por cenon rëndë frymën evropiane të bashkëpunimit dhe të idesë së normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Si i tillë, ky akt është i paprecedent dhe i dënueshëm. Në anën tjetër, qeveria e Kosovës, fton Brukselin zyrtar, përkatësisht, instancat e Bashkimit Evropian, që seriozisht ta marrin këtë çështje, sepse jo vetëm që zyrtarët e Republikës së Kosovës, të komunitetit serb, po maltretohen, por ata mund të jenë edhe të kërcënuar brenda Kosovës, pasi që Serbia po i stigmatizon si tradhtarë të çështjes serbe, përkatësisht të kombit serb",-thotë Matoshi. Që nga dhjetori i vitit të kaluar e deri më tani, në vendkalimet kufitare Kosovë-Serbi, strukturat e sigurisë së shtetit serb kanë ndaluar dhe intervistuar edhe Slobodan Petroviçin, deputet i Kuvendit të Kosovës, Boban Stankoviçin, zëvendësministër i Kulturës në qeverinë e Kosovës, si dhe Nebojsha Jakovljeviçin, këshilltar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në qeverinë e Kosovës. Të gjithë këta, janë anëtarë të Partisë së Pavarur Liberale. Zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Koçijançiç, kanë thënë se kanë pranuar "raporte që zyrtarët e Qeverisë së Kosovës janë ndaluar në pikat e kalimit". "Marrëveshja për lirinë e lëvizjes ofron garanci të qarta për kalimin e papenguar në Serbi dhe anasjelltas. Ne ende po presim për qartësimet nga Beogradi, pas kërkesës sonë për më shumë informacione", ka thënë Koçijançiç. Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Kosovë, Naim Rashiti thekson se është befasues guximi i autoriteteve të Serbisë për të vazhduar me ndalimin dhe intervistimin e njerëzve në vendkalime kufitare dhe për më shumë, pjesëtarët e komunitetit serb. Sipas tij, tingëllon e pabesueshme që institucionet e Serbisë të shkojnë kaq larg sa që për qëllime dhe agjenda politike të njerëzve në pushtet në Beograd, t'i ndalojnë, arrestojnë, persekutojnë dhe frikësojnë të gjithë njerëzit e komunitetit të tyre që mendojnë ndryshe nga ta. "Kjo ka ndodhur vetëm në kohën e Miloshevicit. Prej atëherë, kjo është diçka e re dhe shumë frustuese për popullatën serbe në Serbi dhe në Kosovë dhe fushatat e ndryshme po vazhdojnë. Kjo është një agjendë politike, e cila nuk ka të bëjë me zbatimin e marrëveshjes për lëvizjen e lirë. Kjo ka të bëjë me një agjendë persekutimi, kërcënuese për njerëzit që mendojnë ndryshe dhe ndaj kësaj, të gjithë faktorët ndërkombëtarë po heshtin. Por, nuk e besoj që BE-ja do të mund të luajë ndonjë rol të veçantë",-thekson Rashiti. Ai shton se e gjithë kjo situatë është absurde dhe shfaq bindjen që megjithatë, në një moment të caktuar, do të ketë mobilizim dhe reagime të faktorëve ndërkombëtarë ndaj këtyre zhvillimeve. Por, sipas tij, tani për tani, kjo situatë reflekton pafuqinë e faktorëve ndërkombëtarë në raport me Serbinë. "Është një agjendë e re, e cila kërkon rikonsolidim të pozicionit ndërkombëtar, por deri tek i cili nuk do të vijë shpejt, sepse faktori ndërkombëtar, për 20 vjet ka intervenuar në baza ditore.

## Përfaqësuesit e Preshevës: Bashkimi me Kosovën, e vetmja zgjidhje

# "Lista Serbe" fiton në veri të Kosovës, 4 komunat mbajnë zgjedhje të parakohshme

## *Zgjedhjet, 'Lista Srpska': Fitoi Serbia me 90% të votave*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë ka publikuar rezultatet paraprake të zgjedhjeve të jashtëzakonshme që u mbajtën ditën e diel për kryetar komune në Leposaviç, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Sipas të dhënave zyrtare, kandidatët e "Listës Serbe" kanë marrë mbi 90% të votave ndërsa në garë ishin edhe kandidatë të PDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Pjesëmarrja ishte rreth 42.2 % e qytetarëve me të drejtë vote. Gjatë ditës janë evidentuar disa parregullsi pasi janë lejuar disa qytetarë serbë të votojnë me dokumentacionin e Serbisë. Ndërsa në disa qendra votimi ishin të vendosur flamuj serbë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se në këto zgjedhje qytetarët e asaj ane dëshmuan pjekuri në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës thonë se me mohimin që u bën Serbia të drejtave të shqiptarëve, e vetmja alternativë për qytetarët e Luginës, mbetet bashkimi me Kosovën. Kryetari i Bujanocit dhe Partisë për Veprim Demokratik, Shaip Kamberi dhe Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare dhe ish-kryetar i Preshevës Ragmi Mustafa ishin këtë javë për vizitë në Uashington dhe diskutuan me gazetaren Keida Kostreci për sfidat politike dhe praktike me të cilat përballet Lugina. "Shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit padyshim se me një përkushtim të jashtëzakonshëm pranojnë integrimin brenda territorit të Republikës së Kosovës", tha Mustafa. "Sigurisht se do të ishte varianti më i mirë që Lugina e Preshevës t'i bashkohej Kosovës, por megjithatë ne jemi lojtarë nga jashtë të cilët nuk mund të interferojmë në qëndrimin e kosovarëve sepse nuk mund t'i imponohemi Kosovës", tha Kamberi. Përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës thonë se me mohimin që u bën Serbia të drejtave të shqiptarëve, e vetmja alternativë për qytetarët e Luginës, mbetet bashkimi me Kosovën. Nga ana tjetër, Lista Serbe ka shpallur fitoren e saj në zgjedhjet e jashtëzakonshme të mbajtura në katër komunat veriore të Kosovës. Kandidatët për kryetarë të komunave nga kjo parti kanë bërë të ditur para gazetarëve se në bazë të rezultateve të tyre jozyrtare që posedojnë, Lista Serbe ka fituar këto zgjedhje me mbi 90 për qind të votave. Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiç, fitoren e tij e ka quajtur fitore të popullit serb dhe shtetit të Serbisë në këto hapësira. "Shpall fitoren e Listës Serbe, përkatësisht fitoren e popullit serb. Ajo që dua të them në fillim është se bojkoti i opozitës dhe disa kuazi-satelitëve këtu në terren nuk ka pasur sukses. Lista Serbe ka fituar mbi 90 për qind të votave në katër komunat veriore. Unë kam të dhëna jo zyrtare sipas të cilave në katër komunat veriore Lista Serbe ka fituar 94.24 për qind të votave. Në veri të Mitrovicës kjo përqindje është 90.18, që do të thotë se në raport me zgjedhjet e vitit 2017, 1675 vota më shumë ka marrë Lista Serbe",-ka thënë Rakiç. "Do ta përsëris edhe njëherë, se bojkoti i opozitës nuk ka pasur sukses sipas të cilit është tentuar që populin serb ta çojë në duart e Prishtinës. Faleminderit shtetit të Serbisë, Marko Gjuriçit, Aleksandar Vuçiç, qeverisë së Serbisë, për apelin që i kanë bërë popullit serb për unitet", ka thënë Rakiç. Edhe kandidatët e tjerë për kryetarë të komunave tjera kanë folur, duke thënë se me këtë fitore është dëshmuar fuqishëm fitorja e popullit dhe shtetit të Serbisë këtu. Në fund të kësaj konference për gazetarë, të pranishmëve iu është drejtuar përmes linjës telefonike edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, i cili ka përshëndetur dhe falënderuar popullin serb për daljen masive në këto zgjedhje. Sipas tij, ky është konfirmimi më i mirë për unitetin politik të serbëve rreth interesave vitale dhe nacionale, si dhe interesave më të rëndësishme të shtetit të Serbisë. "Njerëzit tanë kanë dëshmuar energji jashtëzakonisht të madhe dhe dëshirën se duan të luftojnë për të ardhmen e tyre dhe një të nesërme më të mirë për fëmijët e tyre. Me këtë fitore nuk do t'i zgjidhim të gjitha problemet tona, por kemi treguar se duam unitet në zgjidhjen e këtyre problemeve dhe zgjidhjen e përbashkët të tyre. Mendoj se pas të gjitha kërcënimeve nga shqiptarët dhe disa serbë, ky është konfirmimi më i mirë për unitetin politik të luftës për interesat tona vitale dhe nacionale dhe interesat tona më të rëndësishme shtetërore", tha përmes telefonit Vuçiç. Nga ana tjetër kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur procesin e rregullt zgjedhor për zgjedhjen e kryetarëve në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan. Ai në një shkrim të bërë në 'Facebook' ka thënë se qytetarët kanë dëshmuar pjekuri në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, pa ndonjë incident në një proces demokratik, dhe duke votuar për kandidatët që ata besojnë se do iu shërbejnë interesave të tyre. Ndërkohë, zyrtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor kanë vlerësuar të qetë dhe pa probleme ecurinë e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave në veri të Kosovës.



Kreu i 'Listës Serbe', Goran Rakiç

**GORAN RAKIÇ**

"Shpall fitoren e 'Listës Serbe', përkatësisht fitoren e popullit serb. Ajo që dua të them në fillim është se bojkoti i opozitës dhe disa kuazi-satelitëve këtu në terren nuk ka pasur sukses. 'Lista Serbe' ka fituar mbi 90 për qind të votave në katër komunat veriore. Unë kam të dhëna jozyrtare, sipas të cilave, në katër komunat veriore 'Lista Serbe' ka fituar 94.24 për qind të votave".

**ALEKSANDAR VUÇIÇ**

"Njerëzit tanë kanë dëshmuar energji jashtëzakonisht të madhe dhe dëshirën se duan të luftojnë për të ardhmen e tyre dhe një të nesërme më të mirë për fëmijët e tyre. Me këtë fitore nuk do t'i zgjidhim të gjitha problemet tona, por kemi treguar se duam unitet në zgjidhjen e këtyre problemeve dhe zgjidhjen e përbashkët të tyre", - tha përmes telefonit Vuçiç.

INTERVISTA

# ANISA MARKARIAN: Diktatura, si e pashë dhe roli i ëndrrave të mia

Fatmira Nikolli

Përshkruhet mjeshtërisht nga Anisa Markarian, si shumë tablo të romanit të saj, pasi ky roman është si një vijimësi tablosh të jetës shqiptare, si një lloj libri i madh me kapakë të rëndë, ku ne gjejmë jetën tonë. Është një dëshmi, ku ndryshe nga dëshmia dokumentare, ajo është letrare, një letërsi tashmë e lëvruar gjerësisht që nga Pasternaku, Solzhenicini etj., si dhe autorët e gjithë Lindjes europiane pas rënies së Murit të Berlinit, vazhduar me "Shakanë" e Kunderës, "Pallatin e ëndrrave" të Kadaresë dhe shumë e shumë të tjerëve. Luan Rama e nis me këto fjalë një kritike të tijën për romanin e Anisa Markarian "15 ditë prilli". Vetë autorja në një intervistë për "Gazetare Shqiptare" tregon si nisi ta shkruajë, notat autobiografike dhe alegorinë e përdorur. Situatat e absurdit ku gjenden personazhet dhe njeriu i shtypur në diktaturë. Sa e vret një shkrimtar një regjim dhe sa e depersonalizon individin, sa e ndryshon një shoqëri dhe çfarë bën një njeri për të shmangur shtypjen.

**- Anisa, si u ngjiz romani "15 ditë prilli"?**

Romani e ka zanafillën në dy bërthama të hershme: një novelë e shkurtër dhe një skenar filmi. Në dorëshkrimin e librit tim të parë, "Sënduku i kujtimeve" (botuar në vitin 1999 nga MÇM Çabej), bënte pjesë edhe një novelë prej 30 faqesh me titull "Sipas këshillës së miqve", ku rrëfeja historinë e një shkrimtari disident të tradhtuar nga shokët e tij më të ngushtë. Ngjarjet zhvilloheshin kryesisht në burgun e gërryer brenda malit të Urthit. Meqenëse "Sënduku i kujtimeve" u ndërtua si një përmbledhje tregimesh, novela në fjalë nuk u përfshi në të, por tema e pabesisë më mbeti në mendje e më ngacmonte për ta zhvilluar në një vepër më vete. Në vijim, rreth mesit të viteve 2000, pata shkruar një skenar filmi artistik të titulluar "Kosherja e heronjve". Nëpërmjet fatit të një grupi të sëmurësh të mbyllur në një institucion shëndetësor që kishte për mision të prodhonte heronj, u bëhej jehonë ndryshimeve historike që ndodhnin jashtë Kosheres: përmbysja e diktaturës dhe fillimi i një periudhe të turbullt tranzicioni.

**- Ngjarjet e romanit zhvillohen në 15 ditë. Kjo trysni kohore ju shërbeu për t'i dhënë më shumë dinamikë historisë?**



Anisa Markarian

*Shkrimtarja rrëfen si e shkroi romanin "15 ditë prilli"*

Është e vërtetë që përmbledhja e ngjarjeve në një afat kohor të shkurtër i jep rrëfimit ritëm dhe forcë. Por, ideja kryesore ishte të tregoja që shpeshherë mjaftojnë vetëm pak ditë për të ndryshuar rrënjësisht kahun e historisë ose fatin e një kombi.

**- Përse muaji prill?**

Prilli shënon jo vetëm pikëtakimin e dy stinëve, por edhe një lloj "paqartësie" të vetë natyrës. Përkon me një periudhë kur as dimri s'ka dalë përfundimisht, as pranvera s'ka zënë vend mirë. Ka thyerje e befasi interesante. Në planin artistik, shtjellimin e ngjarjeve në muajin prill e kam shfrytëzuar si ndërlidhëse të së shkuarës me të ardhmen. Në mes qëndrojnë 15 ditët e së tashmes me pështjellimin, pasigurinë, çoroditjen dhe rebelimin që i karakterizon.

**- Në roman nuk gjejmë asnjë përcaktim gjeografik që të kuptojmë se në ç'vend të globit zhvillohen ngjarjet e aq më pak ndonjë të dhënë kohore për të ditur se ç'periudhe i referoheni.**




Zgjedhja për t'i vendosur ngjarjet në një hapësirë pa emër e pa datë nuk është aspak e rastësishme. Nënkupton gjithëkohshmërinë e gjithëndodhshmërinë e temës që trajton romani. Njëkohësisht edhe rrezikun që, nëse ulim vigjilencën dhe humbim guximin për të denoncuar e luftuar padrejtësitë, historia tragjike mund të përsëritet.

**- Libri është aq i pasur në përshkrime, saqë lexuesit i krijohet përshtypja se po sheh një film.**

Kjo është plotësisht e vërtetë dhe ju falënderoj që e vutë në dukje. Përpara se ta hidhja në letër, çdo skenë të romanit e kam "filmuar" me mendje për të ndierë atmosferën e përveçme që rrethonte ngjarjet. Atë të fundit të një diktature. Ja përse i kam kushtuar kaq shumë vëmendje përshkrimit të rrethanave dhe analizës së gjendjes psikologjike të personazheve përballë agonisë së regjimit totalitar.

**- Një agoni që zgjat 15 ditë...**

Po. Siç e keni lexuar, reagimet e personazheve në ato "15 ditë prilli" janë nga më të larmishmet. Herë të befasojnë, herë të çorientojnë. Herë të ngjallin admirim, herë të tjera të neverisin. Ndërkohë që pushtetarëve u shket toka nën këmbë, popullit i hapen perspektiva të reja, të shumëndërrura. Të parët përpiqen të përjetësojnë ofiqet që gëzojnë duke u kapur me dhëmbë e me thonj pas zheleve të të Përndriturit; të dytët organizojnë qëndresën dhe projektojnë të ardhmen e tyre.

**- Megjithëse e saktësoni që "15 ditë prilli" nuk është një roman autobiografik, gjatë leximit na krijohet përshtypja se Ida Raez jeni ju vetë. Gjer në ç'masë janë të vërtetë personazhet që popullojnë librin tuaj?**

Personazhet e librit m'i kanë frymëzuar persona realë që kam njohur në situata të caktuara, por e risaktësoj, "15 ditë prilli" nuk është roman autobiografik e akoma më pak roman historik apo rrëfim realist. Ida Raez mbart në vetvete një pjesë të rëndësishme të jetës sime studentore. Veçse, nuk jam mjaftuar me aq. Kam krijuar një figurë komplekse me kulme befasuese. Sa më shumë sfilitet fizikisht, aq më shumë lartësohet karakteri i saj i paepur. Nëse romani do të përshtatej një ditë kinematografikisht, roli që do të kisha dëshirë të interpretoja do të ishte ai i Idës. Çdo aktore do ta ëndërronte t'i besohej ai rol. Si autore e romanit, Ida Raez më është njëri nga dy personazhet më të dashur.

**- Tjetri është Teo?**

Po. Pacienti që pata takuar gjatë praktikës së ortopedisë. Për t'i shpëtuar shërbimit të detyrueshëm ushtarak, në moshën 18-vjeçare kishte injektuar vajguri në gjurin e vet. Me kalimin e viteve, i ishte formuar një lloj tumori dhe këmba i ishte gangrenizuar plotësisht, duke e bërë të pashmangshëm cungimin ortopedik. E nisur nga kjo e dhënë, Teon e përfytyrova si një personazh të akullt e oportunist; pothuajse cinik. Por përballë ngjarjeve madhore që jeton në planin personal dhe atë shoqëror, ndërgjegjësohet moralisht e bëhet më i ndjeshëm shpirtërisht. Monologu i Teos në shtrat me Bulëzën dhe roli nismëtar në grevën e të sëmurëve të Kosheres dëshmojnë për kthesën fisnike që merr personazhi i tij duke u bërë edhe më njerëzor.

**- Romani "gumëzhin" nga një mori e pafund personazhesh dhe skenash ku ndërthuren tragjikja me komiken, grotesku me mbinatyralen, magjia me djallëzinë, dyfytyrësia me ndershmërinë e dalë mode, ndjenjat e pastra me perversitetin... Cirku i madh i jetës?**

Mund ta quajmë edhe kështu. Një cirk ku artistët kërcejnë nën fshikullimat e kamxhikut dhe spektatorët duartrokasin me pahir, për të mos përfunduar nën thundrat e centaurëve. Për t'ia rrokur sa më mirë kuptimin alegorisë së përdorur, libri duhet lexuar në 3 plane. Plani i parë është romani i suksesshëm i Vlad Krelës, "Qiellin e ka ngrënë tenja". Përfaqëson fazën e nënshtrimit dhe të mbylljes së banorëve brenda qytetit-bunker. Planin e dytë e përbëjnë ngjarjet e 15 ditëve që përkojnë me fazën e rebelimit dhe të shembjes së diktaturës. Plani i tretë është romani i ardhshëm i shkrimtarit, "Rrëfime nga Moskundi", që përfaqëson fazën e denoncimit dhe të dënimit të tmerreve të ishregjimit.

**Si do ta cilësonit mënyrën tuaj të të shkruarit?**

Mendoj se shkruaj një letërsi pamore, të rrymës së realizmit magjik.

**-Cilët janë shkrimtarët që kanë ndikuar në farkëtimin e stilit tuaj?**

Buzzati, Garcia Marquez, Kafka, Kadare, Rulfo, Allende... Filmat e disa regjisorëve si Fellini, Bergman, Spielberg, Audiard, Almodovar, Kusturica..., gjithashtu.

**-Ç'mesazh dëshironi t'u përcillni lexuesve më të rinj në moshë nëpërmjet romanit tuaj?**

Të rriten qytetarë vigjilentë e të vëmendshëm, sepse despotët lindin në çdo kohë. Kur u japim tepër pushtet, kur nuk u kërkojmë llogari, kur u lejojmë ta mbajnë kolltukun për periudha të gjata kohe, kur i brohorasim apo i votojmë symbyllur.

FJALA

# LEKË TASI

Nga Lekë Tasi*

# Armiku i popullit në sytë e një artisti

Armiku i popullit" mund të jetë një lokucion që impresionon njerëzit e thjeshtë. Sipas momentit që thuhet, tonit, dhe nivelit mendor të dëgjonjësve, ndodh që tremben se dikush i rrezikon. Ne që i përjetuam gjatë diktaturës gjyqet dhe shprehjen "armik i popullit" drejtuar njerëzve të ndershëm, e patëm ndier në çast tendenciozitetin. Kjo vërtetohej nga debati i përciptë dhe nga vendimi përherë me vdekje. Ngutja për të vrarë erdhi duke u shtuar. Po edhe kujtdo në botë i kujtohen regjimet diktatoriale me atë maninë për të eliminuar kundërshtarët. Po qe se niset me vrasje, armiqtë edhe shpiken, ashtu si shpejtojmë pedalet që të mos biem. Kjo daton që me Revolucionin Francez. Qysh atëherë u përdor toni kërcënues në hapësirën institucionale, dhe pastaj drejt në gijotinë. Në regjimet demokratike njerëzit buzëqeshin me gjëra të tilla. Njerëzit e mençur kudo, me ta dëgjuar një akuzë të tillë, ashtu, me ton të paapelueshëm, fyhen mendërisht, veçse, të ndodhur mes turmës, druajnë ta kundërshtojnë. Sepse turma përreth tkurret dhe aderon pa u ndier në atë që vendos i fuqishmi. Kjo ngre edhe te të mençurit një ndjenjë frike. Duhet kurajë për t'i dalë kundra. Diktaturat e dinë këtë mekanizëm psikologjik, shtojnë presionin dhe kështu, përveç të mençurve, frika hyn edhe te turmat kur ndihen të lodhura ose të velura nga britmat dhe reagojnë me ndonjë gjest. Kështu thellohet tirania. Alternativa do të ishte debati me gjakftohtësi, i cili sigurohet me demokraci, e cila arrihet me mirëqenie dhe përsoset me shkollim tërësor. Po si? Me ç'model? Përgjigjja na vjen nga krahasimi i qytetërimeve dhe mes kulturave. Ka pasur regjime autoritare, demokratike, ose dhe diktatura të ndritura e deri regjime kapterësh të shkathtë, ose maniakësh kriminelë. Rezultatet ndryshojnë sipas sistemit po edhe sipas vetive personale të krerëve. Mbi të gjitha duhet të ndahet shkaku i dhunës dhe mashtrimit qysh në themel: regjimet janë i djathtë ose i majtë, respektivisht autoritar por me referim hyjnor dhe përballë tij, ai liridashës me referim jo Zotin, por njeriun si burim dhe qëllim të tij. Që aty artikulohet politika dhe kultura që e prodhon, pra edhe mendësia. Te kjo e fundit do jepet beteja. Popujt kanë më fort mendësi se mendim. Ata preferojnë mirëqenien ndaj dhunës, por bien viktima të dhunës kur duan ta shtojnë mirëqenien, për shkak të mendësisë së rëndomtë, që përhapet me imitim. Beteja është mendore: si të diktohet armiku, (pra dhe "armiku i popullit", qoftë real, ose sajesë e defekteve tona ose inateve) si trajtohet ai, a shërohet ai dhe integrohet, apo përjashtohet, dënohet dhe zhduket? Historia është pak a shumë po ajo, e dhunshme. Por meqë mendimi origjinal i djathtë ka lidhje me besimin në Perëndi, mund të na shërbejë si model, rasti i KryeEngjëllit Mikhail, në kontest me Satanin (armiku par excellence për fetarin) se kush prej tyre do të merrte shpirtin e Moisiut. I tha vetëm: "Zoti të gjykoftë". Regjimet e djathta (monarkike ose jo) nuk e kanë zbatuar fort këtë gjakftohtësi dhe dëgjesë ndaj Zotit, por një pjesë e vogël e kanë tentuar; kurse të majtat fare më lirshëm kanë shkarë në arbitraritet ekstrem, duke shkelur e vrarë njeriun për hir të njeriut, që pretendonin se e mbronin. Madje, nëse ka pasur një fre moral e moderacion human, në të dyja rastet, djathtas-majtas, ky vihet re te krerët me një mbeturinë frikë Perëndie, ose me temperament të dhembshur. Shoqëria duke u kultivuar këtë model e përkthen në sens autokritik të liderit e qytetarëve, rast i lumtur kur realizohet.



Lekë Tasi

*"Kur niset me vrasje, armiqtë shpiken"*

Ai çmohet njëzëri, por përherë me vonesë, mbasi nevoja për siguri të ketë bërë dëme të mëdha. Kurse emocioni, qoftë edhe i nxitur nga drejtësia o barazia ka çuar gati gjithmonë në eksese të përgjakshme, që pasohen nga pendime, por vetëm në raste humbjeje… Kjo përgjumje e ndërgjegjes te fitimtarët e rehatuar mbi fitime të përkohshme dhe të rrezikuara e bën historinë po edhe jetën e përditshme një mbretërim të padrejtësisë, gjë që na thuhet troç te lokucioni princi i kësaj bote, që i referohet Satanit. Armiku në fakt është ai dhe rri duke gatuar armiq që janë në fakt armiq të tij, kur grupe o individë, të neveritur nga përgjumja marrin guximin të përpiqen për të drejtën pa përfituar vetë, por si shprehje empatie.

Vetëm përballur me këtë lloj kuraje, Satani e humbet betejën. Na e kujton këtë fjala "Por merrni zemër, unë e munda botën!" (Gj.16:33) e Atij që vet farefisi e urreu dhe e dorëzoi ta mbërthenin në kryq. Kjo është ta pozosh drejt konceptin "armik i popullit" në një botë ku të gjithë duan të gëzojnë jetën, madje edhe në dashuri reciproke, sepse e kanë këtë veti fiziologjike, por s'arrijnë të mposhtin armikun që kanë brenda vetes, të vogël, të parëndësishëm, por rezistent. Shkolla në këtë drejtim duhet ta përhapë dijën: të kalohet tek kërkimi i të rëndësishmes, që, për efekt të saj, armiqësia të zëvendësohet me empatinë.

***Fjala e mbajtur në konferencën e organizuar nga Autoriteti i Dosjeve***

## QË TË MOS HARROHET KËNGA SHQIPTARE

Një tjetër iniciativë për të mos e lënë këngën shqipe të harrohet, pas sjelljes në kohë të muzikës së viteve '90-të me "Albanian Pop Rock 90's" dhe repertorit të vajzave e grave, në "Albanian Pop Rock Ladies", gazetarja Kozeta Kurti ka një tjetër ide, në vazhdim të kësaj linje: "Albanian Pop Rock Duets". Duetet më të mira të muzikës së lehtë shqiptare deri në fund të viteve '90-të do të vijnë me orkestracione të reja, mbrëmjen e 2 qershorit në Amfiteatrin e Tiranës. Repertor i zgjedhur nga Aleksandër Gjoka e Aurela Gaçe, Ledina Çelo e Sabri Fejzullahu, Fitnete Tuda, Parashqevi Simaku, Nertila Koka etj., do të interpretohen nga një gjeneratë më e re këngëtarësh, midis të cilëve Orgesa Zaimi, Evi Reçi, Kamela Islamaj, Era Rusi, Mateus Frroku, Luiz Ejlli etj.

Elegancë harqesh dhe forcë instrumentesh elektrike, bashkojnë në këtë ngjarje muzikore artistët e rinj përballë krijuesve të këtyre këngëve të arta të muzikës shqiptare, të cilët këtë herë janë spektatorë të radhëve të para, duke ndjekur me emocion se si kënga e tyre mund të jetojë gjatë në kohë e të zërë vend në breza të rinj.

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni i Ditës

# Ndërhyrje të jashtme në opinionin publik e mjedisin politik

Nga Edval Zoto

*(vijon nga faqja 1)*



... politike në hapësirën euro-atlantike, sidomos në vende lehtësisht të prekshme nga shumëllojshmëria e aktorëve të jashtëm dhe mënyrat e tyre tradicionale dhe jo-tradicionale. Duke marrë parasysh ndërhyrjen e papërshtatshme dhe të jashtëligjshme ruse në zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara në vitin 2016, ndërhyrje e cila u provua faktikisht nga një hetim i zgjeruar i Byrosë Federale të Hetimit (FBI), i cili u bë publik më herët gjatë këtij viti dhe debatin rreth saj, që ka shoqëruar tashmë tërë mandatin e Presidentit Trump, është e papërjashtueshme mundësia e ndërhyrjeve të ngjashme, në të gjitha vendet e NATO-s, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë e më gjerë.

Aktorët e jashtëm me synime të fshehta, sipas përkufizimeve më të vona, identifikohen si shtete ose subjekte të huaja të angazhuara në mënyrë të fshehtë ose gjysmë të fshehtë për të deformuar opinionin publik, ose të një pjese të tij, vendimmarrjen dhe politikëbërjen nëpërmjet mënyrave e veprimeve nga më të ndryshmet, kryesisht nëpërmjet mbështetjes financiare ose politike, propagandës, dezinformimit, nxitjes së divergjencave të brendshme, denigrimit të subjekteve publike të veçanta, faktorizimit të elementëve përçarës ose të parëndësishëm, shpërqendrimin e vëmendjes etj. Kanalet e komunikimit të përdorura për këto veprime janë kryesisht mediat, e gjithnjë e më shumë ato elektronike. Por, në një botë gjithnjë e më tepër të nënshtruar ndaj efekteve globalizuese, kuptimi i aktorëve të jashtëm pashmangshmërisht do të zhvillohet brenda dualitetit aktorë të jashtëm-aktorë të brendshëm, që bashkohen nga interesi i ngjashëm i momentit. Në rastin e zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA, subjektet ruse kishin si interes rënien e popullaritetit e imazhit publik të kandidates Clinton, dhe shmangien e zgjedhjes së saj në Presidencë. Të njëjtin interes kishin edhe shtabi elektoral dhe militantët e kandidatit Trump. Por, për mbështetësit e Trump, ky interes i ngjashëm do të lejonte në përfundim të fushatës thjesht zgjedhjen e kandidaturës së tyre të preferuar në zyrën e Presidentit, ndërsa për aktorët e jashtëm rusë, synimi përfundimtar është i paqartë, pavarësisht se shumëkujt i pëlqen spekulimi se qëllimi rus ishte zgjedhja e një presidenti amerikan, të përshtatshëm për pritshmëritë ruse apo të pëlqyeshëm për ta. Paparashikueshmëria dhe mosnjohja e qëllimit përfundimtar, apo efekteve të tij është pikërisht karakteristika dalluese e aktorëve të jashtëm, në krahasim me ato të brendshëm. Shtete të fuqishme, si SHBA, i penalizojnë ndërhyrjet nga aktorë të jashtëm në çështje kritike siç janë zgjedhjet dhe politika e brendshme, por dhe vënë në veprim një sërë mekanizmash mbrojtës, kryesisht të ndërmarra nga organe të specializuara të sigurisë, të cilat nëpërmjet epërsisë së informacionit zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e të panjohurës dhe përmbajnë në kufij të sigurt veprimtarinë e jashtme.

Rreziku i ndërhyrjes së aktorëve të jashtëm në politikën e brendshme dhe atë të jashtme të vendeve të Ballkanit, e sidomos në Shqipëri, është përmendur gjerësisht e tradicionalisht, ndërkohë që merr një vëmendje të veçantë në vitet e fundit për shkak të zgjerimit të vazhdueshëm të kufijve të Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe të Bashkimit Evropian në drejtim të vendeve ballkanike, dhe përkundër interesave strategjike apo pragmatiste të aktorëve të ndryshëm të jashtëm të Lindjes, ku bëjnë pjesë Rusia, Kina, Turqia, Vendet e Gjirit, por edhe subjekte më pak tradicionale si organizata të krimit të organizuar dhe grupime politike nacionaliste apo fetare fundamentaliste. Situata politike e brendshme në Shqipëri, e acaruar skajshëm që pas daljes së forcave kryesore opozitare nga parlamenti më 21 shkurt dhe nisjes së protestave popullore, ku jo pak raste kanë degjeneruar në akte dhune krijon në mënyrë domethënëse mundësi për ndërhyrje nga aktorë të jashtëm.

Me qëllim identifikimin e ndërhyrjeve të jashtme në situatën e acaruar politike në Shqipëri, për një periudhë tremujore nga dalja e opozitës nga parlamenti, kam vëzhguar pothuajse të gjitha gazetat, të cilat trajtojnë situatën politike vendore e të cilat botohen në print dhe 'online' ("Gazeta Shqiptare", "Panorama", gazeta "Tema", "Shekulli", "Telegraf", "Sot", "Shqip", "Mapo", "Koha Jonë", "55", "RD" etj.). Për efekt të këtij vëzhgimi janë konsideruar si ndërhyrje të jashtme lajme mbi veprimtari të kryera nga subjekte të huaja ose të vendosura jashtë vendit, por të përcjella mediatikisht në Shqipëri, ose opinione nga autorë të huaj, të cilët janë shprehur mbi zhvillimet politike në vend në mediat shqiptare. Janë lënë jashtë këtij monitorimi sigurisht deklaratat e karakterit zyrtar, si thirrjet nga institucione ndërkombëtare të mirënjohura, zyrtarë të tyre, apo edhe zyrtarë të institucioneve të vendeve perëndimore, të cilët u janë drejtuar palëve zyrtarisht apo janë shprehur në cilësinë e veshjes zyrtare apo funksionit që mbajnë në institucionet përkatëse. Nga vëzhgimi është vënë re se pothuajse të njëtrajtshme, nga kjo kategori "komunikuesish" janë bërë thirrje për qetësimin e situatës politike, rikthimin e opozitës në parlament, dënimin shpërthimit të dhunës në protesta, uljen e forcave politike në bisedime, si dhe moscenimin e zgjedhjeve vendore të qershorit.

Vëzhgimi ka identifikuar 17 raste të veçanta artikujsh (komunikime origjinale, jo përsëritëse) të cilat kanë si autorë apo lajmbërës 13 subjekte të veçanta, të cilat janë kualifikuar si "të jashtme", ndërkohë nëse i përmbahemi parakushtit të fshehtësisë ose mosekspozimit të qartë të subjekteve lajmprodhuese, aktorë të jashtëm apo komunikime të prodhuara nga aktorë të jashtëm me synime të fshehta mund të kualifikohen vetëm 2 prej tyre. Ndërkohë, të gjitha këto komunikime, pavarësisht nga karakteristikat e subjekteve komunikuese, shprehin mbështetje për qëndrimet apo veprimtarinë e opozitës, si dhe mbështesin argumentet dhe arsyet e qëndrimit politik të opozitës shqiptare në shkallë të ndryshme përputhshmërie. Për disa nga subjektet komunikuese, qëndrimi i tillë është i pritshëm dhe i kuptueshëm për shkak të lidhjeve të qarta organike midis opozitës dhe këtyre subjekteve, ndërsa për dy prej tyre nuk ka asnjë lidhje. Gjithsesi, numri i vogël i rasteve në tërësi lejon një paraqitje të shkurtër për secilin, apo për secilën kategori. Nga 13 subjektet e identifikuara:

" 2 janë subjekte të diasporës, të lidhura historikisht dhe ngushtësisht me mjedisin politik shqiptar:

o Federata Pan-Shqiptare Vatra në Michigan, SHBA, e cila kronografikisht ka qenë i pari subjekt "i jashtëm" që ka prodhuar një lajm të komunikuar në Shqipëri (artikulli i datës 21 shkurt, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull: "Letra, djegia e mandateve, opozita gjen mbështetje në SHBA", dhe

o Z. Elez Biberaj, fjalimi i të cilit në një eveniment të gazetës "Dielli", e botuar po nga "Vatra", u botua gjerësisht i plotë ose me pjesë në mediat shqiptare (artikull i datës 7 prill, në gazeta "55" 'online', me titull: "Sfidat e konsolidimit të demokracisë shqiptare").

" 2 janë subjekte të diasporës, por të lidhura organikisht me partiti të opozitës: subjekti i parë është:

o "Një grup protestuesish të organizuar nga dega e Partisë Demokratike në Athinë, e drejtuar nga z. Fatmir Gjoci" (artikull i datës 11 mars, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull: "Rama ik' edhe në Athinë, emigrantë protestojnë kundër qeverisë"), ndërsa subjekti i dytë është,

o "Drejtuesi i degës së Partisë Demokratike në Londër, z. Naim Hasani" (artikull i datës 16 mars në "Gazeta Shqiptare" print, me titull: "Nga Londra në protestë, Hasani: PD duhet të vijë në pushtet").

" 1 është një subjekt në tranjtën e një grupimi të paidentifikuar, "grupim protestuesish në afërsi të konsullatës shqiptare në Nju Jork", aktivitet i cili u mediatizua në Shqipëri për shkak të njoftimit të bërë nga z. Sali Berisha (artikull i datës 24 shkurt në "Gazeta Shqiptare" print, me titull "'Rama ik', Berisha: Shqiptarët nisin protestën në Nju Jork").

" 4 subjekte janë qytetarë të huaj me ekspozim politik dhe marrëdhënie historike të qëndrueshme me mjedisin socio-politik në Shqipëri, të cilët pavarësisht funksioneve zyrtare, në rastet e identifikuara janë shprehur në cilësinë personale:

o Deputeti gjerman i partisë Bashkimi Social Kristian z. Christian Schmidt, raportues për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm të Parlamentit të Gjermanisë (artikulli i datës 16 mars, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull "Deputeti gjerman Schmidt: Edhe qeveria mban përgjegjësi. CDU, Henze: PD-së iu asgjësua çdo liri në Kuvend, duhen zgjedhje të reja",

o z. Martin Henze, kryekëshilltar ekonomik në partinë gjermane Bashkimi Kristian Demokrat, i cili ka subjekti më aktiv në periudhën e studimit, me tri komunikime të veçanta (1- artikull i datës 16 mars, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull "Deputeti gjerman Schmidt: Edhe qeveria mban përgjegjësi. CDU, Henze: PD-së iu asgjësua çdo liri në Kuvend, duhen zgjedhje të reja"; 2 - artikull i datës 25 prill, në gazeta "Koha Jonë" 'online', me titull "Këshilltari i CDU së Angela Merkel: Kriza zgjidhet me qeveri tranzitore"; 3- artikull i datës 6 maj, në gazeta "Koha Jonë" 'online', me titull "Këshilltari i CDU: Si zgjidhet kriza politike").

o Znj. Doris Pack, eurodeputete dhe presidente e organizatës së grave në brendësi të Partisë Popullore Evropiane, si dhe ish-deputete e Bashkimit Social Kristian gjerman, me dy komunikime të veçanta (1 - artikulli i datës 3 prill, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull ("Doris Pack: Ambasadorët mbyllin sytë për situatën në Shqipëri"; 2 - artikulli i datës 5 maj, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull: "Kriza politike, Pack: Zgjidhja, përmes zgjedhjeve të lira").

o Z. Oliver Jens Schmitt, profesor në Institutin për Historinë e Europës Lindore në Universitetin e Vjenës në Austri, me dy komunikime të veçanta (1 - artikull i datës 19 mars, në gazeta "55" 'online', me titull: "Historiani e politiologu zviceran Jens Schmitt: Edi Rama, demagog e autoritar që hiqet si artist"; 2- artikull i datës 4 prill, në gazeta "55" 'online', me titull: "Schmitt për Der Standard: Rama promovoi drogën, tani përdor Kosovën").

" 2 subjekte janë gazetarë të gazetave të huaja të mirënjohura, por që në argumentimin e tyre janë mbështetur në burime shqiptare. I pari:

o z. Giancarlo Padovan, gazetari italian i "Il fatto Quotidiano", i cili ka botuar një artikull në gazetën italiane, por që është ribotuar edhe në Shqipëri e që sjell lajmin mbi rezultatet e një sondazhi të kryer nga kompania "IPR Marketing", e cila e ka kryer sondazhin për llogari të medias shqiptare "Ora News" (artikulli i datës 15 prill, në "Gazeta Shqiptare" print, me titull "Gazeta italiane: Sondazhet favorizojnë opozitën përballë PS-së"), ndërsa i dyti,

o z. Peter Tiede, gazetar i gjermanes "Bild", i cili ka botuar një artikull mbi ngjarjet në Shqipëri, por që bazohet në deklarata të forta të figurave publike shqiptare z. Ylli Manjani dhe z. Basir Çollaku (artikull i datës 14 maj, në gazeta "55" 'online', me titull "'Bild', shuplakë të fortë Ramës/ Reagon Berisha: Damkosje fatale për të dhe narkoshtetin e tij").

" 2 subjektet e mbetura janë edhe ato, të cilat përputhen më mirë me përkufizimin e aktorëve të jashtëm, pasi ka →

Opinioni i Ditës

# Rilindja e vrasësve politikë

Nga Andi Bushati

*(vijon nga faqja 1)*




.. ish-gardisti i grupit të zjarrit, tani kandidat i rilindjes për Bashkinë e Matit ka qenë tejet i përfshirë në krimin shtetëror të tetë viteve më parë. Ndryshe nga sa pretendoi kryeministri në një konferencë shtypi se Malaj nuk kishte përgjegjësi ligjore, se nuk qe i përfshirë në krim dhe se ai ka dhënë informata të vlefshme për atë ditë, dokumenti i gazetës fliste për të kundërtën.

Aty ishte e shkruar e zeza mbi të bardhë se Malaj jo vetëm se qe rreshtuar në anën e gabuar të barrikadës, por ende pa u tharë mirë gjaku i të vrarëve, ai ishte shpërblyer me katër paga mujore, nga një për çdo viktimë, nga drejtuesi e zinxhirit kriminal. Madje, madje, shpërblimi i tij qe nga më bujarët në atë listë të gjatë.

Po pse njeriu që qëlloi pa iu dridhur syri drejt e mbi trupa, ish-komandanti i Gardës, Ndrea Prendi, duhej ta shpërblente gardistin e konvertuar në socialist? Për çfarë shërbimi? Se ishte treguar i zellshëm në shpërndarjen e përgjakshme të manifestimit opozitar? Se kishte fshehur gjurmët më pas bashkë me ata që fshinë serverin, zhdukën gëzhojat dhe ndërruan shulat?

A është rastësi që masa e parave që ai mori në dorë është e njëjtë me atë të Ndrea Prendit, Alfred Ahmetcenaj që gjuajti plot 117 plumba atë ditë, apo e Agim Llupos, që u kap nga kamerat duke qëlluar nga ajo dritarja qorre e Kryeministrisë.

Çfarëdo broçkullash justifikuese të nxjerrë nga goja shefi i qeverisë, përgjegjësia e kandidatit të tij për kryebashkiak nuk mund të anashkalohet.

Edhe sikur Malaj të mos ketë kryer asnjë krim, edhe sikur për angazhimin e tij të mos meritojë asnjë ditë burg, ai ka mbi vete një njollë të madhe morale. Si para dhe pas krimit, ai qëndroi në anën e vrasësve. Gjaku i të vrarëve për të u shndërrua në kartëmonedha 5 mijë lekëshe.

Do të mjaftonte vetëm kjo, që ai të mos pranohej as si anëtar i thjeshtë në partinë që "mbron" kujtimin e të viktimave e jo më pastaj të ishte një nga të përzgjedhurit e saj për 61 njësitë administrative vendore.

Dhe këtu problemi e tejkalon fatin personal të një gardisti të shndërruar në rilindas.

Sepse rasti i tij është konfirmimi i një rregulli për amnistimin e të gjithë atyre që i qëndruan në krah Berishës pas krimit makabër.

A nuk u bë koalicioni i 1 prillit me Ilir Metën që quajti viktimat kokëpalarë?

A nuk morën pjesë në qeverinë e parë të rilindjes plot pesë ministra që kishin mbrojtur si të tillë komplotin e grushtit të shtetit?

A nuk është televizioni që bën sot apologjinë e Ramës, ai që vërtetonte tezën se të vrarët ishin qëlluar nga turma?

A nuk gjenden mbrëmjeve në tryezën e kryeministrit të njëjtët oligarkë që e shfrytëzuan fillimin e fundit të Berishës për t'u pasuruar dhe më shumë për veten e tyre?

Në këtë kuptim as rehabilitimi i Agron Malajt nuk përbën ndonjë surprizë. Ngjitja e tij e ngadaltë

në hierarkinë e pushtetit, fillimisht si drejtor i OSSHE, pastaj si kryetar i PS në rrethin ku do të bëhet kryebashkiak, ka ecur paralel me zhbërjen e ndjeshmërisë ndaj asaj që ndodhi në 2011.

Rasti i tij nuk është thjesht promovimi i një njeriu të pushkës apo të krimit, sipas modeleve të Roshit, Ndokës, Prengës e me radhë. Këtë herë, në zgjedhjet lokale pa garë, PS-ja nuk ka nevojë për të fortë dhe banditë që t'i japin vota.

Prandaj katapultimi i Malajt përbën një rast historik. Ai është një sinjal se ndjeshmëria ndaj krimit politik duhet zbutur; një mesazh se riprodhimi i kloneve berishiste nuk duhet të ngjallë të njëjtën frikë; një paralajmërim se hendeku mes të keqes dhe dënimit të saj nuk ka pse të jetë aq i pakapërcyeshëm sa ç'propagandohej.

Ndryshe, nuk ka si shpjegohet që PS-ja të propozojë si model të shoqërisë së sotme një njeri që u shpërblye me para në dorë për krimin e 21 janarit: vetëm nëse do të relativizojë peshën e vrasjeve në emër të pushtetit, vetëm nëse do të rilindë ata që janë të gatshëm ta bëjnë këtë.

---

shumë elemente që lënë dyshime jo vetëm mbi synimet e komunikimeve të përcjella në median shqiptare prej tyre, por sidomos mbi identitetin e autorëve si dhe mbi vërtetësinë e pohimeve në brendësi të artikujve, të cilat janë të paargumentuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu është e habitshme se si pavarësisht se janë produkte gazetareske aspak profesionale e me mungesa të elementëve më bazikë identifikues, këto artikuj kanë depërtuar pa problem në mediat më popullore shqiptare. Këto subjekte janë:

o Gazeta 'online' gjermane "Die Freie Welt", e cila ka botuar një artikull pa autor mbi situatën politike në Shqipëri. Ky artikull është shpërndarë në mediat sociale nga z. Sali Berisha dhe më pas ka gjetur rrugën e botimit në gazeta "55" 'online'. (artikulli i datës 22 shkurt, në gazeta "55" 'online', me titull: "Shkrimi i medias gjermane/ Berisha: Maduro dhe Edvini, dy armiq të votës së lirë").

o Dr. Ana L. Scheer, një individ i identifikuar vetëm nga emri, që në disa raste në mediet shqiptare figuron dhe si Anna L. Scheer, e cila ka botuar më herët në "OffGuardian", një artikull me titullin sensacional "Kryeministri shqiptar çon vendin drejt konfliktit civil" (artikull i datës 14 maj, në "BalkanWeb" 'online'). Ky subjekt, sipas vetidentifikimit një grua me titull shkencor, është ndoshta aktori më i fshehtë i identifikuar nga ky vëzhgim. Platforma në të cilën artikulli i mësipërm është botuar fillimisht në gjuhën angleze është "OffGuardian", një platformë 'online', e cila u jep mundësi lexuesve e komentuesve të censuruar nga prestigjiozja angleze "The Guardian", të shprehin pikërisht ato mendime apo komente, të cilat "The Guardian" nuk i gjykon të përshtatshme për t'i botuar në hapësirën e vet 'online'. Artikulli i Scheer i 14 majit pason dy të tjerë të botuar në "OffGuardian", gjithnjë me në fokus situatën politike shqiptare dhe me doza të forta kritikash e akuzash ndaj qeverisjes aktuale, i pari i datës 18 prill, me titull "A do të dështojë sërish Shqipëria në hapjen e negociatave me BE-në?". (I njëjti artikull, nga Scheer është vëzhguar të jetë botuar në gjuhën shqipe në "Koha Jonë", në datën 18 prill, (artikulli i datës 18 prill, në "Koha Jonë" 'online', me titull: "A do të dështojë sërish Shqipëria në hapjen e negociatave me BE-në?"); i dyti i datës 29 prill dhe me titull "Protesta të mëdha dhe kriza politike në Shqipëri".

Një kërkim i thjeshtë në "Google" me emrin e autores Scheer nuk nxjerr rezultate mbi shkrime të tjera të saj përpos të mësipërmve, por është interesante se të paktën artikulli i saj i fundit mbi "konfliktin civil" në Shqipëri, është botuar dhe në "TheRussophile.org", një portal rus agregator lajmesh mbi Rusinë dhe nga "vende të lidhura me interesat ruse".

Rezultatet e këtij vëzhgimi tregojnë se vetëm në një rast evidentohet një lidhje e qartë midis një subjekti anonim që ka gjetur rrugën e komunikimit mediatik masiv me shqiptarët dhe mediave me origjinë nga një aktor i jashtëm tradicional, Rusia. Pjesa dërrmuese "të jashtmëve" të identifikuar, nuk janë dhe aq të jashtëm, ose më saktë lidhjet e tyre me aktorë të brendshëm të mjedisit socio-politik shqiptar janë tepër të qarta dhe synimet e tyre përfundimtare lehtësisht duket se përputhen më shumë me synimet përfundimtare të aktorëve shqiptarë se sa me synime të panjohura të huaja. Vëzhgimi gjithashtu tregon se vetë mediat shqiptare shpesh tregohen të pakujdesshme në mosidentifikimin e qartë të mediumeve apo komunikuesve të jashtëm dhe mungesën e verifikimit të tyre, por edhe në moscilësimin e duhur të cilësisë në të cilën shprehen e i drejtohen individë apo subjekte të huaja publikut shqiptar. Po ashtu, janë edhe vetë politikanët shqiptarë, ata që tërhiqen lehtësisht nga sensacionaliteti i deklaratave që vijnë nga jashtë vendit dhe menjëherë luajnë rolin e mediumit, pa shfaqur kujdes apo përgjegjësi për t'u mbrojtur nga komunikime me origjinë të panjohur. Është e qartë se, përsa u përket medieve shqiptare, një shfaqje e një përgjegjësie më të lartë në këtë aspekt do të ndikonte në zvogëlimin e sensacionalitetit të lajmeve, por gjithashtu do të zvogëlonte rrezikun e subjektivizimit nga ana e aktorëve të jashtëm me synime të fshehta, duke mundësuar edhe informimin e shëndetshëm të shoqërisë.

---

## HOROSKOPI

### DASHI
Të lindurit e kësaj shenje do të jenë mjaft rezultativ në punë këtë të martë. Ata që janë në kërkim të një pune të re duhet të konsultohen me një anëtar të familjes ose me një mik. Sa i përket jetës personale përpiquni të zgjidhni konfliktet me miqtë sa më shpejt të mundeni.

### DEMI
Keni shumë shanse për t'u promovuar gjatë ditës së sotme. Rekomandohet t'i kushtoni më shumë vëmendje vetes dhe veçanërisht shëndetit tuaj. Përpiquni të ecni sa më shumë në këmbë dhe bëni ushtrime në ajër të pastër.

### BINJAKET
Duket sikur shefi në punën tuaj nuk i kupton nevojat e punonjësve, megjithatë mos lejoni që kjo të ndikojë në moralin tuaj. Nëse keni ndërmend të ankoheni lidhur me këtë, sigurohuni mirë para se të flisni.

### GAFORJA
Lërini të tjerët të merren vetë me punët e tyre. Mund të keni qëllime shumë të mira, por një person nuk mund të ndihmojë këdo. Përpiquni të fokusoheni në punën tuaj, pasi do t'ju shfaqen mundësi për rritje profesionale.

### LUANI
Do të jetë një nga ato ditë, ku gjithçka do të shkojë mbarë. Nëse keni ndërmend të blini diçka të kushtueshme, është dita e duhur për ta bërë këtë. Megjithatë tregohuni të kujdesshëm kur të bëni pagesën.

### VIRGJERESHA
Është e rëndësishme t'i përkushtoheni vetes. Ka gjasa që të zhvilloni një intervistë të rëndësishme gjatë kësaj të marte. Përpiquni të shmangni shprehjet klishe, por ndjehuni të lirë ta shpreheni ashtu sikurse ju dëshironi.

### PESHORJA
Fokusohuni më shumë tek e tashmja dhe jo tek ato çfarë mund të ndodhin në të ardhmen e afërt, pasi kjo do të bënte që të humbnit disa mundësi të rëndësishme. Ndaj, shfrytëzoni momentin dhe përpiquni të ecni përpara.

### AKREPI
Eksperimentet tuaja të fundit me stilin e veshjes ka gjasa që t'ju shpërblehen sot, pasi do të fitoni vëmendjen e një personi mjaft interesant. Megjithatë mos u joshni nga komplimentet e tepërta. Qëndroni pranë atyre që ju kanë mbështetur gjithmonë.

### SHIGJETARI
Nëse sot do të keni më shumë kohë të lirë se ditët e tjera, përpiquni ta menaxhoni sa më mirë atë. Rekomandohet të merrni këshillën e një mikut tuaj lidhur me këtë. Bëni shumë kujdes nëse keni ndërmend të bëni blerje të ndryshme këtë të martë.

### BRICJAPI
Mund t'ju vijë një ide sot, e cila do t'ju duket brilante. Partneri/partnerja mund të kërkojnë më shumë vëmendje nga ana juaj dhe ka gjasa të shfaqen probleme mes jush, te cilat do të kalojnë shpejt. Bëni kujdes me regjimin ushqimor.

### UJORI
Mund t'ju kërkohet të ndërmerrni një vendim të rëndësishëm. Ka gjasa t'ju duhet të hiqni dorë nga një marrëdhënie e papërcaktuar. Analizoni çdo detaj lidhur me një vendim të mundshëm dhe tregohuni të fortë për të zgjedhur opsionin më të mirë.

### PESHQIT
Dita e sotme nuk do të shkojë ashtu sikurse ju e kishit menduar, sidomos nëse nuk keni fjetur aq sa duhet. Vëzhgoni me kujdes njerëzit rreth jush dhe tregohuni të gatshëm nëse dikush do të ketë nevojë për ndihmën tuaj.




## Finalja e Kupës së Shqipërisë

# Tirana-Kukësi do të luhet më 2 qershor në orën 19:00

Në fakt, data dihej, ishte e përcaktuar për datën 2 qershor, ndonëse ka pasur një tentativë nga ana e Kukësit për ta afruar këtë datë për shkak se mund të humbasë shërbimet e sulmuesit Rexhinaldo, i cili del i lirë më 31 maj. Por FSHF, ashtu siç edhe është e drejtë, i ka qëndruar strike kalendarit të vendosur më herët, ndërsa sot ka zyrtarizuar vetëm orën e sfidës. Kështu, finalja e madhe e Kupës së Shqipërisë mes Kukësit dhe Tiranës do të zhvillohet më 2 qershor, ora 19:00 në fushën neutrale të "Elbasan Arenës". Gjithashtu, janë mësuar dhe "finalet" e tjera të vogla. Kështu, përballjes mes Vllaznisë dhe Bylisit për kampionen e Kategorisë së Parë do të zhvillohet të enjten në orën 16:00 në "Niko Dovana" të Durrësit, ndërsa finalja e Kategorisë së Dytë mes Tërbunit dhe Devollit, do të luhet në "Tofik Jashari" të Shijakut të mërkurën në orën 13:30.



Jeton Selimi

Edi Reja ka thirrur edhe Mihajn e Hykën. Sot pritet të mësohen të gjithë lojtarët

# Rikthehet Ermir Lenjani, Telushi e bën "sefte"

## *Lista e Kombëtares, zbulohen emrat e parë*

FSHF ka vendosur që të mos bëjë ende publike listën e futbollistëve të grumbulluar nga trajneri Edi Reja për stërvitje apo për ndeshjet me Islandën dhe Moldavinë. Por vetë futbollistëve u janë dërguar ftesat për aktivitetet e muajit qershor dhe pritet që të ruhet pjesa më e madhe e grupit të ndeshjeve të fundit nën drejtimin e Panuçit. Një prej emrave në listë që është konfirmuar zyrtarisht edhe nga klubi i tij është ai i mbrojtësit Enea Mihaj. Futbollisti 20-vjeçar shihet si një nga elementët e perspektivës dhe fakti që është aktivizuar rregullisht me Panetolikos dhe kërkohet nga klube të njohura në Greqi e jashtë saj, e bëjnë një emër që duhet parë me shumë kujdes. Mihaj është grumbulluar me kombëtaren që në shtatorin e vitit të kaluar, por situata për të ka qenë paksa e çuditshme pasi regjistron vetëm 1 minutë zyrtarisht si pjesë e Shqipërisë. Ai ishte debutimi i tij, në ndeshjen kundër Skocisë në Gllasgou ku u aktivizua në minutën e 89-




të, vetëm pak çaste në katërkëndorin e gjelbër për të vulosur përfundimisht praninë e tij me Shqipërinë dhe për të larguar hijet e ftesës nga Greqia. Më pas, vetëm 9 minuta në një miqësore me Jordaninë ku një dëmtim i pësuar e la për disa muaj jashtë. Por Mihaj kërkon më shumë tanimë me Edi Rejan, ku të gjithë e nisin nga e para dhe në këto ditë grumbullimi, do të ketë shansin të tregojë vlerat e tij e pse jo të bindë trajnerin që është ai një nga elementët të cilëve u duhet besuar për të ardhmen.

Në grumbullimin që pritet të nisë sot në Durrës, që do i ndihmojë teknikut Edi Reja për të njohur më nga pranë grupin e lojtarëve të Kombëtares, pritet të ketë edhe rikthime. Emri i parë është ai i Ermir Lenjanit. Siç mëson "Panorama Sport", anësori i majtë që aktivizohet tek Sioni në Zvicër, ka marrë një ftesë nga Reja. Në grumbullimin e fundit të muajit mars, Lenjani nuk mori një ftesë fillimisht nga Panuçi, dhe deklaroi nëpërmjet një deklarate, se sa të jetë ai trajner, nuk do të shkonte më në Kombëtare. Ndërkohë, me Edi Rejan duket se është një frymë e re, dhe Lenjani pritet që të bashkohet menjëherë me ekipin Kombëtar. Gjithashtu, edhe Jahmir Hyka pritet të marrë një ftesë, dhe do të jetë pjesë e grumbullimit. Shtatshkurtri që aktivizohet te Netanja në Izrael, po bën mirë me golat e shënuar në kampionat, dhe ndoshta mund të ketë një vend në listën përfundimtare të të grumbulluarve për ndeshjet e qershorit.

Jo vetëm Lorenc Trashi, Partizani do të ketë edhe një futbollist tjetër në Kombëtare, pasi trajneri Edi Reja ka ftuar edhe mesfushorin Bruno Telushi. Kjo është hera e parë që futbollisti vlonjat bëhet pjesë e kuqezinjve. Sipas "Supersport", trajneri italian ka çuar ftesat në klubin e kuq për Trashin dhe Telushin. Një lajm mjaft i mirë ky për klubin e Partizanit, që pas fitimit të titullit, do të ketë më shumë përfaqësues në ekipin kombëtar. Është një lajm i mirë që futbollistë të Superiores po ftohen prej tij në Kombëtare. Telushi ka bërë një sezon të jashtëzakonshëm me Partizanin, duke qenë një nga lojtarët kyç në formacionin e trajnerit Gega. Ai e ka merituar plotësisht ftesën e trajnerit Reja.

YLLI FRANCEZ

# Mbape tremb PSG-në, Real Madridi fërkon duart

Kilian Mbape tremb PSG dhe trazon merkaton e transferimeve me deklaratën e tij të fundit publike. Ylli francez me sa duket nuk ndihet i plotësuar në Lige 1, pas 4 sezonesh po mendon largimin, nuk është aspak një thashetheme merkatoje, por fjalë të thëna nga vetë talenti më i mirë në botë. "Ky është sezoni im i 4-ët në Ligë 1. Mendoj se ka ardhur momenti të marr më shumë përgjegjësi. Shpresoj që këtë ta bëj te PSG, do më bëhej qejfi, ose në ndonjë klub tjetër për një projekt të ri. Këto fjalë të thëna nga Mbape kanë kapur të pa përgatitur tifozët e PSG ndërsa ka bërë që gjysma e tifozëve



në Europë të ëndërrojnë. Mbape lëshoi këtë bombe medatike gjatë momentit kur u vlerësua me çmimin si lojtari i ri më i mirë në kampionatin francez. Mendoj se ka ardhur momenti ta them këtë, unë jam nga ato njerëz që kur e them diçka e them sepse ashtu e ndiej. Nëse do kem më shumë përgjegjësi te PSG do qëndroj nëse jo do të nis diku tjetër një projekt të ri". Këto fjalë të Mbappe janë një sinjal i qartë dhe i pastër për sheikun Nasser Al-Khelaifi, në Paris ka vend vetëm për një yll, Mbappe ose Neymar, Al-Khelaifi duhet të zgjedh. Nuk është një sekret që Real Madrid kërkon shërbimet e Mbape, me Zidane në stol këto zëra u shtuan edhe më shumë. Mbetet për t'u parë se çfarë do të vendosin drejtuesit e PSG, sido të jetë përfundimi, në merkato këtë verë do të kemi një ndërmjet Mbape dhe Nejmar.

## Pagë faraonike për spanjollin

# Mançester Siti blindon Guardiolën me 22 milionë euro në sezon

Mançester Siti as që ka ndërmend të privohet nga Pep Guardiola dhe për ta larguar atë nga çdo tundim në merkato është gati ta mbulojë me ar teknikun spanjoll. Lajmi bëhet i ditur nga mediat angleze. Sipas "The Sun", kampionët e Premier League i kanë ofruar trajnerit rinovimin e kontratës edhe për pesë vite të tjerë. E përditshmja britanike zbulon edhe detajet financiare të ofertës, që tashmë është në tavolinën e Pep Guardiolës. Bëhet fjalë për një kontratë me 115 milionë euro për pesë vitet e ardhshëm, ose më saktë më shumë se 22 milionë euro në sezon. Kjo do të



thotë se të ardhurat e spanjollit do të rriten me 5 milionë euro në sezon. Një vlerësim maksimal për trajnerin që shkroi historinë e Mançester Siti, që për herë të parë arriti të fitojë titullin kampion në Premier League dy herë radhazi. Champions League mbetet objektivi më i rëndësishëm dhe për ta arritur këtë, "Qytetarët" janë gati të plotësojnë çdo kërkesë të Guardiolës në merkato. Ndërkohë me këtë lëvizje, klubi anglez shuan shpresat e gjithë rivalëve që ëndërrojnë Pep Guardiolën në pankinë. Duhet të dorëzohet edhe Juventus, që shpresonte ta bindte spanjollin të merrte drejtimin e "Zonjës së vjetër".

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Miller e Verdi-t.
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Derain.
11. Kishte 100 Teba.
12. Është vija e portës
13. Në fund te rritjes.
14. Drejtori Lokale Përmet.
15. Inicialet e Seagal.
16. King Cole i muzikes.
17. Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
21. Artikull spanjol.
23. Janë fjalëpakë.
25. Fillojnë titrat.
26. Është i mërzitshmi.
27. Ashtu si jeton heremiti.
29. U kompozua nga Ravel.
30. Janë spanjolët dhe portugezët.
32. Një kitarë indiane.
33. Janë edhe ato të sigurimit.
35. Është e harlisur në xhungël.
37. Mbyllin fushatat.
38. Kështu thirrej Eisenhower.
40. Ai dhe ajo.
41. Fillojnë vallen.
42. Inicialet e Delon.
44. Kalohet në gjumë.
45. Martini që qe këngëtare
46. Një thirrje me emra.

VERTIKAL
1. U quajt qyteti atomik.
2. Qyteti i Abrahamit.
3. Italia në tabela.
4. Sapo fillojnë.
5. Nemo ai i Nautilus.
6. Janë në botë
7. Një tabu islamike
8. I famshmi Pacino.
10. Janë si falimentime
11. Ngjyhet një në tavolocë.
12. Timo i Mato Grudës.
14. Janë borxhlinj.
17. E përditshmja që ke në dorë.
18. Carson i fumetti-t.
19. U shkrua nga Sartre.
20. Në fund të vitit.
22. Është lloj poezie.
24. Janë shtëpi... qeni.
25. Janë kapriçiot.
27. Verifikuar pjesërisht.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Është sekrete në derë.
34. Kodi i celularit.
36. Daja i Amerikës.
39. Kaluar në krye.
43. Fillojnë detyrën.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Atkinson, alias Mister Bean.
5. Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
10. Ferrara regjisor.
12. Kalohet në gjumë.
14. Të parat në sondazh.
15. Është nofka.
16. Një treshe në skenë.
19. Nuk i tregohen babait.
21. Gjysmë tatimi.
23. Berenger aktor.
24. Në mes të një forme.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë nazet
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.
40. Janë galeri në hekurudhë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë tatimi
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot ngas Tantali.
51. Janë brinjët në skuadër.
52. Qendër fitimi



VERTIKAL
1. Është edhe ajo emërore.
2. Është edhe ai mbretëror.
3. Të parat në Wellington
4. Një vegël
6. Është vendi aderues
7. Është emirat.
8. Mbyllin portat.
9. Pak latinisht.
11. Janë zjarrvënës.
13. Qyteti i përjestshëm.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Këngetarja tullce.
20. Inicialet e Moravia-s.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Filloje takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Është llogarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Fillojnë tjetrën.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | | 5 | | | 9 | |
| | | 3 | | | | | | 2 |
| 5 | 9 | | | 1 | | | | |
| | 1 | | | | | 8 | | |
| 7 | 2 | | | 6 | | | | |
| | | 9 | | 2 | 7 | | | 6 |
| 6 | 5 | | | | | | | |
| | | | 8 | | | | 6 | 3 |
| | | | | | | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 9 | 1 | 2 | 3 | 5 | 8 | 6 | 7 |
| 2 | 7 | 6 | 4 | 8 | 1 | 9 | 5 | 3 |
| 5 | 3 | 8 | 9 | 7 | 6 | 4 | 1 | 2 |
| 6 | 1 | 2 | 3 | 9 | 7 | 5 | 8 | 4 |
| 3 | 4 | 9 | 1 | 5 | 8 | 7 | 2 | 6 |
| 7 | 8 | 5 | 6 | 4 | 2 | 3 | 9 | 1 |
| 8 | 2 | 7 | 5 | 6 | 4 | 1 | 3 | 9 |
| 9 | 6 | 4 | 8 | 1 | 3 | 2 | 7 | 5 |
| 1 | 5 | 3 | 7 | 2 | 9 | 6 | 4 | 8 |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

### FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | ■ | K | O | M | E | N | T | A | T | O | R | E | T |
| O | P | E | R | A | T | ■ | E | T | R | ■ | A | T | R |
| M | E | N | ■ | T | ■ | P | R | ■ | A | F | ■ | I | A |
| I | P | ■ | M | ■ | D | A | M | A | R | I | ■ | K | K |
| K | I | N | E | T | I | K | E | ■ | E | N | D | E | T |
| ■ | T | I | R | A | N | E | T | ■ | T | T | E | ■ | A |
| T | A | R | I | K | A | T | E | T | ■ | E | T | A | T |
| E | ■ | ■ | M | A | K | E | T | ■ | S | T | A | N | I |
| K | O | M | E | T | E | ■ | ■ | L | H | ■ | R | D | ■ |
| A | R | I | E | ■ | T | ■ | F | A | T | I | ■ | R | E |
| ■ | E | R | ■ | ■ | ■ | T | A | L | E | N | T | E | T |
| F | L | A | K | A | ■ | A | N | A | T | E | M | A | T |

### FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | A | L | O | R | E | ■ | K | ■ | ■ | ■ | S | P | A |
| E | M | I | L | E | ■ | K | O | T | ■ | A | ■ | O | L |
| R | I | M | A | ■ | K | A | L | E | N | D | A | R | I |
| I | T | A | ■ | K | A | P | I | T | E | N | E | T | ■ |
| N | A | ■ | M | O | N | O | T | O | N | ■ | K | E | L |
| O | ■ | P | I | R | A | T | E | R | I | A | ■ | T | E |
| S | A | N | D | A | L | E | ■ | I | ■ | ■ | K | ■ | D |
| ■ | S | T | I | L | E | ■ | I | ■ | ■ | M | A | S | A |
| F | T | ■ | S | E | T | ■ | K | A | M | A | T | E | ■ |
| A | R | T | I | ■ | ■ | P | O | L | E | M | I | K | A |
| J | O | E | ■ | K | R | A | T | E | R | I | ■ | T | R |
| I | ■ | R | O | M | A | N | E | T | ■ | A | R | I | S |

## Argëtim filozofik

Argëtim filozofik



-.E drejta nuk mund të jetë kurrë e të dy palëve, ajo i përket vetëm njërës.

-.Gabimi më i madh që mund të bëni në jetën tuaj është të kesh frikë vazhdimisht se do bëni gabim.

- Kënaqësia i bën të varfërit të pasur, pakënaqësia i bën të pasurit të varfër.

## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 H | 2 I | 16 J | 1 A | ■ | ■ | 12 | 7 | ■ | 7 | 8 | 6 | 11 |
| 1 | 4 | 3 | 8 | ■ | 10 | 1 | 14 | ■ | 5 | ■ | 1 | 8 |
| 18 | 1 | 8 | ■ | 5 | 3 | 9 | 3 | 8 | 2 | 12 | 2 | ■ |
| 2 | 8 | ■ | 5 | 6 | 4 | 6 | 9 | 1 | 9 | 2 | ■ | 8 |
| 8 | ■ | 12 | 1 | 15 | 2 | 8 | 1 | 11 | 2 | 7 | 8 | 3 |
| 6 | 1 | 11 | ■ | 12 | 9 | 1 | ■ | ■ | 8 | ■ | 9 | 11 |
| 9 | 3 | 1 | ■ | 2 | 6 | ■ | 7 | 16 | 2 | ■ | 1 | 3 |
| 3 | ■ | 7 | ■ | 4 | ■ | 1 | 8 | 6 | ■ | 8 | 2 | 14 |
| ■ | 13 | 2 | 7 | 7 | ■ | 15 | 6 | 3 | 11 | ■ | 4 | 6 |
| 4 | 2 | 12 | 2 | ■ | 8 | ■ | 11 | ■ | 1 | 13 | 3 | 17 |
| 1 | 4 | 3 | 7 | 8 | 3 | 20 | 2 | 7 | 6 | ■ | 8 | 1 |
| 8 | 1 | ■ | ■ | 18 | 1 | 9 | 1 | 12 | 1 | ■ | 2 | 8 |

## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | A | ■ | D | D | D | ■ | ■ | ■ | M | E | K |
| ■ | N | O | I | R | E | T | ■ | D | I | T | A |
| ■ | A | ■ | H | E | T | I | M | O | R | E | ■ |
| H | ■ | B | A | J | A | D | E | R | A | ■ | T |
| I | P | ■ | T | T | L | ■ | T | E | ■ | U | R |
| P | E | N | J | ■ | ■ | S | A | Z | A | N | I |
| E | R | ■ | E | ■ | S | ■ | L | A | K | I | M |
| R | A | S | T | E | T | ■ | E | T | I | ■ | A |
| B | N | T | ■ | P | A | K | T | ■ | L | E | T |
| O | D | A | ■ | I | N | A | ■ | L | I | Z | ■ |
| L | O | R | ■ | K | E | T | E | R | ■ | R | K |
| A | R | T | ■ | E | T | I | K | E | T | A | T |

## Thënie të mençura

-.Është akt kriminal vjedhja e një çante, e guximshme vjedhja e një pasurie, dhe madhështi vjedhja e një mbretërie. Akuza zvogëlohet kur faji rritet.

- Teori është kur njeriu din gjithçka dhe asgjë nuk funksionon. -Praktikë është kur gjithçka funksionon, por askush nuk e di përse. Tek ne teoria dhe praktika janë të bashkuara: asgjë nuk funksionon dhe askush nuk e di përse.


GAZETA SHQIPTARE
RUSSIA 2018
LAJME
KALENDARI
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
Life
Brikena Duva:
VIP
BLUE TOOTH
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al